



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

STRATEGJIA KOMBËTARE E SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE, 2023-2030



MARS 2023

FALENDERIME

Strategjia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve, 2023– 2030 është hartuar nga Grupi Ndërinstitucional i punës, i ngritur me Urdhërin e Kryeministrit nr. 165, datë 08.09.2022, me anëtarë:

- *Hantin Bonati* Kryetar –MIE
- *Erjola Muka* Anëtar – MIE
- *Gerta Ismailaja* Anëtar – MIE
- *Gea Baduni* Anëtar – MIE
- *Kledia Ngjela* Anëtar – MIE
- *Anisa Gjodedaj* Anëtar – MIE
- *Eliana Gjinali* Anëtar – SASPAC
- *Enea Hoti* Anëtar – MB
- *Arben Xhaferi* Anëtar – MB
- *Valion Cenaliaj* Anëtar – MFE
- *Almira Ferraj* Anëtar – MFE
- *Zhaneta Miska* Anëtar – MSHMS
- *Bukurie Çika* Anëtar – MBZHR
- *Ylli Hoxha* Anëtar – MTM
- *Kujtim Bebja* Anëtar -- AKM
- *Arduen Karagjozi* Anëtar – AMBU
- *Rovena Metoja* Anëtar – AMBU
- *Ndriçim Shani* Anëtar – ERRU
- *Flauers Shoshi* Anëtar – AKUM
- *Albana Jani* Anëtar – AKUM
- *Adela Kila* Anëtar – AKUM
- *Lindita Molla* Anëtar – ISHP
- *Elisabeta Poçi* Anëtar – SHUKALB

PËRMBAJTJA

PJESA I:	KONTEKSTI STRATEGJIK	5
1	PËRMBLEDHJE E GJENDJES AKTUALE TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE	6
1.1	INFORMACION I PËRGJITHSHËM.....	6
1.1.1	<i>Gjeografia, Hidrografia dhe Klima</i>	<i>6</i>
1.1.2	<i>Demografia</i>	<i>7</i>
1.1.3	<i>Ekonomia</i>	<i>7</i>
1.1.4	<i>Burimet Ujore.....</i>	<i>7</i>
1.2	KUADRI LIGJOR AKTUAL QË NDIKON NË SHËRBIMET E FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE	10
1.3	KUADRI INSTITUCIONAL DHE ORGANIZATIV	12
1.4	SITUATA AKTUALE DHE ANALIZA E PERFORMANCËS SË SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIMEVE ..	15
1.4.1	<i>Organizimi i shërbimeve.....</i>	<i>15</i>
1.4.2	<i>Aksesi në shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve</i>	<i>16</i>
1.4.3	<i>Cilësia e Shërbimit.....</i>	<i>17</i>
1.4.4	<i>Eficienca e shërbimeve.....</i>	<i>18</i>
1.4.5	<i>Financat e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve</i>	<i>19</i>
1.4.6	<i>Infrastruktura dhe Investimet në Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve</i>	<i>20</i>
1.4.7	<i>Përballeshmëria e tarifave</i>	<i>22</i>
1.4.8	<i>Sfidat Kryesore të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve</i>	<i>22</i>
PJESA II:	VIZIONI, MISIONI DHE QËLLIMET E POLITIKËS.....	23
2	VIZIONI	23
2.1	MISIONI I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIME	24
2.2	PARIMET KRYESORE TË STRATEGJISË SË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIME	24
2.3	QËLLIMET E POLITIKËS DHE REZULTATET / MASAT PRIORITYRE	25
2.4	POLITIKAT STRATEGJIKE NË MBËSHTETJE TË MASAVE PRIORITYRE PËR SEKTORIN	32
PJESA III: PROJEKTET/PROGRAMET KOMBËTARE TË ZHVILLIMIT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË	38	38
3	INVESTIMET MBËSHTETËSE TE POLITIKAVE STRATEGJIKE; PBA 2023-2025.....	38
3.1	INVESTIMET PËRBËRESE TË PLANEVE STRATEGJIKE PËR ZBATIMIN E DIREKTIVAVE PËR UJIN E PIJSHËM DHE UJËRAT E NDOTURA	39
PJESA IV: ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE	42	42
MONITORIMI	42	42
4	HYRJE.....	42
4.1	PLANET E DETAJUARA TË ZBATIMIT	42
4.2	MONITORIMI DHE RAPORTIMI I STRATEGJISË	42
4.3	<i>PËRDITËSIMI I STRATEGJISË.....</i>	<i>43</i>
PJESA V. PLANI I VEPRIMIT DHE BURIMET FINANCIARE PËR ZBATIM	49	49
5	PLANET E VEPRIMIT NË MBËSHTETJE TË MASAVE PRIORITYRE.....	49
5.1	NEVOJAT DHE BURIMET E FINANCIMIT	49
5.2	NEVOJAT KAPITALE PËR ARRITJEN E QËLLIMEVE TË POLITIKËS DHE MASAVE PRIORITYRE	49
5.3	NEVOJAT KORENTE DHE KAPITALE TOTALE TË INVESTIMEVE PËR PERIUdhËN E PLANIFIKIMIT	51
5.4	STRUKTURA E TARIFAVE DHE PËRBALLUESHMËRIA.....	53
ANEKSI 1 FORMATI I PLANIT TË VEPRIMIT TË KOSTUAR DHE DETAJUAR	63	63
ANEKSI 2 FORMATET E MASAVE PRIORITYRE	87	87

LISTA E SHURTIMEVE DHE TERMAVE

AKUM	Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
ALL	Lekë Shqiptar (monedhë)
AMBU	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
ASPA	Shkolla Shqiptare e Adminstratës Publike
CAPEX	Shpenzimet kapitale
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
FU&K	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime
INSTAT	Instituti i Statistikave
KBU	Këshilli i Baseneve Ujore
KKU	Këshilli Kombëtar i Ujit
MFE	Ministria e Financës dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
OPEX	Shpenzimet Operimit dhe Mirëmbajtjes
OZHQ	Objektiva për Zhvillimin e Qëndrueshëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
RAT	Reforma Administrativo- Territoriale
SHUKALB	Shoqata Ujësjetllës-Kanalizime e Shqipërisë
UPA	Uji pa të Ardhura
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZABU	Zyra e Administrimit të Basenit Ujor

PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK

Hyrje

Shqipëria është një vend që e sheh veten si një komponent integral i projektit të zgjerimit evropian. Integrimi në BE është objektivi gjeostrategjik dhe politik i Shqipërisë, duke u mbështetur në politikat e saj kombëtare dhe ndërkombëtare. Procesi i pranimit mori një zhvillim të dukshëm pas rekomandimit pozitiv të Komisionit Evropian për hapjen e negociatave, gjë që gjithashtu është një inkurajim për të rritur më tej ritmin e reformave.

Qeveria Shqiptare ka prioritet parësor sigurimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane të menaxhuara në mënyrë eficiente dhe të sigurt, me qëllim rritjen e standardeve të jetesës dhe mirëqenies së popullsisë. Reforma e qeverisë synon përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane, të cilat do të ndihmojnë në reduktimin e nivelit të varfërisë dhe do të kontribuojnë në rritjen dhe qëndrueshmërinë ekonomike.

Strategjia Sektoriale për Shërbimet Ujësjiellës Kanalizime 2023-2030, paraqet në mënyrë të qartë, specifike, sasiore dhe kohore vizionin, misionin, qëllimin e politikave dhe Planet e Veprimit, në përputhje me angazhimet e vendit tonë drejt arritjes së objektivave për zhvillimin e qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara. Kjo strategji do të shqyrtohet nga Këshilli i Ministrave për të bashkërenduar objektivat dhe prioritetet kryesore të sektorit Ujësjiellës Kanalizime në Republikën e Shqipërisë, hartimin e propozimeve për zbatimin, financimin e politikave me qëllim arritjen e këtyre objektivave brenda periudhës 7 vjeçare. Strategjia ndërthur gjetjet dhe analizat e kryera nga konsultimet e Grupit Ndër Institucional të Punës dhe aktorët e tjerë të sektorit, duke përfshirë një vlerësim të detajuar të situatës aktuale, kuadrin ligjor dhe rregullator, shpenzimet publike të planifikuara dhe burimet e financimit për sektorin e ujit.

Shqipëria është bashkësponsorizuese e Rezolutës së Kombeve të Bashkuara për *"Aksesin me Ujë të Pijshëm të sigurtë dhe Kanalizime si e drejtë e njeriut"*. Vendi ynë është i angazhuar të demonstrojë, përmes fjalëve dhe veprimeve, që dhe pse i vogël dhe në zhvillim mund t'i përgjigjet një problematike globale, duke bërë atë ç'ka i takon për të garantuar barazi për të gjithë qytetarët përsa i përket të drejtave të njeriut në lidhje me ujin e pijshëm dhe kanalizimet. Epoka e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ) është duke u zhvilluar dhe përfshin 17 objektiva aspirimi, 169 rezultate dhe 232 indikatorë që synojnë transformimin global brenda 12 viteve të ardhshme. Ekziston një objektiv specifik për ujin dhe kanalizimet, i cili shkon përtej ofrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime drejt menaxhimit të ujërave të ndotura, cilësisë së ujit në mjedis, efikasitetit të ujit, menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe mbrojtjes së ekosistemeve ujore si tregues të rëndësishëm.

Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm përbëjnë një kornizë gjithëpërfshirëse, e cila kërkon një qasje sistematike me kapacitete të mjaftueshme dhe që garanton mundësinë për një kthim të sigurt të investimit. Sigurimi i ofrimit të shërbimit me ujë të pijshëm të sigurt dhe të përballueshëm për të gjithë deri në vitin 2030 kërkon investime madhore në infrastrukturë, sigurimin e shërbimeve sanitare dhe ruajtjen e higjienës në çdo nivel. Mbrojtja dhe ripërtëritja e ekosistemeve të lidhura me ujërat sic janë pyjet, malet, parqet ujore dhe lumenjtë është thelbësore nëse duam të evitojmë mungesën e ujit. Nevojitet edhe më shumë bashkëpunim ndërkombëtar për të inkurajuar efikasitetin e ujit dhe për të zbatuar teknologjitë e trajtimit në vendet në zhvillim.

Qeveria e Shqipërisë është e vetëdijshme për përgjegjësinë që ka për mbrojtjen e burimeve natyrore të vendit si një pasuri e madhe kombëtare. Duke patur parasysh këtë fakt, kjo Strategji synon të japë kontributin e saj në mbrojtjen dhe administrimin e këtyre burimeve natyrore jo vetëm sot, por për të gjithë brezat që vijnë. Për këtë arsye, kjo strategji është një hap i madh dhe realizimi i saj do të përmbushë premtimin për të ofruar ujë të pijshëm të sigurt, si dhe kanalizime për ujërat e ndotura urbane për të gjithë, në të ardhmen.

1 Përmbledhje e Gjendjes Aktuale të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve

1.1 Informacion i Përgjithshëm

Qëllimi i Strategjisë është të përmirësojë cilësinë e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime për qytetarët e Shqipërisë. Gjithashtu, të mbështesë zhvillimin ekonomik të vendit, bazuar në kryerjen e një shërbimi kryesor të infrastrukturës. Për të realizuar përmbushjen e këtij qëllimi, është thelbësore që strategjia të përcaktojë disa të dhëna bazë dhe informacione që kanë të bëjnë me popullsinë, modelet e saj të ndryshimit dhe gjendjen ekonomike të popullsisë.

Strategjia synon vendosjen e qëllimeve dhe objektivave kombëtare për përmirësimin e aksesit me shërbimin ujësjellës kanalizime. Adresimi i problematikave në sektorin e ujësjellës kanalizimeve synohet të arrihet mbi një kuadër transparent nëpërmjet angazhimit të vazhdueshëm institucional dhe mobilizimit të burimeve financiare të nevojshme.

1.1.1 Gjeografia, Hidrografia dhe Klima

Shqipëria shtrihet në pjesën jugperëndimore të Gadishullit Ballkanik kufizuar nga Mali i Zi në veriperëndim, Kosova në verilindje, Republika e Maqedonisë së Veriut në lindje dhe Greqia në jug dhe juglindje. Shumica e vendit ka reliev malor, duke përfshirë Alpet shqiptare në veri, Malet e Korabit në lindje, Malet Cerauniane në jug dhe Malet e Skënderbeut në qendër. Bregdeti i vendit prek Detin Adriatik në veriperëndim dhe Detin Jon në jugperëndim duke përfshirë edhe Rivierën Shqiptare. Shqipëria është rreth 72 km (45 mi) nga Italia në të gjithë Ngushticën e Otrantos që lidh Adriatikon me Jonin.

Vendi ka një rrjet të dendur lumenjsh të karakterizuara nga një shkallë e lartë prurjesh. Ata i përkasin baseneve ujorë të Adriatikut, Egjeut dhe Detit të Zi. Lumenjtë e vendit kryesisht burojnë në gjysmën malore lindore të vendit dhe kanë grykderdhjen e tyre në perëndim përgjatë brigjeve. Ata ushqehen nga shkrija e borës nga malet e mbuluara me dëborë ose nga reshjet e bollshme që bien në lartësi më të larta. Tetë lumenj të mëdhenj, së bashku me degët e tyre të shumta, përbëjnë sistemin e lumenjve të vendit.

Me më shumë se 250 liqene, Shqipëria ka në territorin e saj dy prej liqeneve më të mëdhenj në Evropën Jugore (Liqeni i Shkodrës dhe i Ohrit) dhe një nga më të vjetrat në botë. Liqenet e vendit janë kryesisht me origjinë karstike ose glaciale. Shqipëria është gjithashtu vendi i shumë lagunave me formë, madhësi dhe strukturë të ndryshme. Lagunat janë të vendosura kryesisht përgjatë bregdetit në perëndim të vendit dhe gjithashtu në juglindje. Ato kontribuojnë në produktivitetin e përgjithshëm të ujërave bregdetare duke mbështetur një shumëllojshmëri të habitateve dhe ekosistemeve.

Shqipëria karakterizohet nga një klimë mesdhetare kontinentale me dimër të ftohtë dhe verë të nxehtë. Shqipëria ka burime të mjaftueshme ujore, të barabarta me 8,700 metra kub për frymë në vit.

Ultësirat kanë dimër të butë, mesatarisht rreth 7°C (45°F). Temperaturat verore është mesatarisht 32°C (90° F), lagështia është e ulët. Në ultësirën jugore, temperaturat variojnë mesatarisht rreth 5°C (41°F) gjatë dimrit dhe 30°C (86°F) gjatë verës.

Mesatarja vjetore e reshjeve në ultësirën perëndimore është nga 1.000 milimetra (39.37 in) deri në më shumë se 1.500 milimetra (59.06 in) në vit, me nivele më të larta në veri. Gati 95% e reshjeve bie në dimër. Vargmalet, kryesisht në zonat malore karakterizohen nga reshje më të dendura dhe me frekuenca të shpeshta. Nuk janë të disponueshme të dhëna të mjaftueshme dhe vlerësimet ndryshojnë shumë, por mesataret vjetore janë ndoshta rreth 1,800 milimetra (70,87 in) dhe shkojnë deri në 2,550 milimetra (100,39 in) në disa zona veriore.

1.1.2 Demografia

Popullsia rezidente e Shqipërisë, siç përcaktohet nga Instituti i Statistikave (INSTAT), është vlerësuar 2,845,955 banorë më 1 janar 2020. Shkalla e përgjithshme e fertilitetit të vendit prej 1.51 fëmijëve të lindur për grua është një nga më të ultat në botë. Dendësia e popullsisë është 259 banorë për kilometër katror. Jetëgjatësia e përgjithshme mesatare është 78.5 vjet; ku 75.8 vjet për meshkujt dhe 81.4 vjet për femrat. Shqipëria është vendi i 8-të më i populluar në Ballkan dhe renditet i 137-të më i populluar në botë. Popullsia e vendit u rrit në mënyrë të vazhdueshme nga 2.5 milionë në vitin 1979 deri në 1989, kur arriti në 3.1 milionë. Është parashikuar që popullsia nuk mund të arrijë numrin e saj të pikut të vitit 1989 deri në vitin 2031, duke marrë parasysh shkallën aktuale të lindjeve dhe nivelin e migrimit.

Rreth 53.4% e popullsisë së vendit jetojnë në qytete. Tre bashkitë më të mëdha (Tiranë, Durrës dhe Fier) përbëjnë gjysmën e popullsisë totale. Gati 30% e popullsisë totale banon në Bashkinë e Tiranës, pasuar nga Bashkia Durrës me 11% dhe Bashkia Fier me 10%. Mbi 1 milion njerëz janë të përqendruar në Tiranë dhe Durrës, duke e bërë atë zonën më të madhe urbane në Shqipëri. Tirana është një nga qytetet më të mëdha në Gadishullin Ballkanik dhe renditet e shtata me një popullsi rreth 800,000 banorë.

1.1.3 Ekonomia

Transformimi ekonomik i vendit vazhdon të bazohet mbi potencialin dhe mundësitë e tij. Megjithatë, kriza globale financiare evidentoi dobësitë e modelit të rritjes dhe theksoi nevojën për t'u zhvendosur nga nxitja e konsumit drejt rritjes së investimeve dhe eksportit.

Qeveria e Shqipërisë në vitet e fundit ka filluar një program të gjerë të fokusuar në qëndrueshmërinë makroekonomike dhe fiskale, stabilizimin e sektorit financiar, përmirësimin e sektorit energjitik, pensionet dhe administratën vendore. Progresi i rëndësishëm, i nxitur nga reformat e vazhdueshme, ka krijuar kushtet për rimëkëmbjen e besimit të biznesit dhe rritjen e kërkesës së brendshme, duke përfshirë rritjen e investimeve publike dhe të eksporteve. PBB-ja reale e Shqipërisë në 2021 u rrit me 8.5%, duke e krahasuar me vitin 2020¹.

1.1.4 Burimet Ujore

Burimet e ujit të pijshëm përbëjnë një aset të madh për Shqipërinë. Sasia mesatare e ujit të pijshëm në dispozicion llogaritet në 8,700 metra kub për frymë në vit², që është një nga më të lartat në Evropë. Burimet e ujit të pijshëm në vend ekzistojnë në formën e burimeve natyrore, lumenjve, liqeneve dhe ujërave nëntokësore. Furnizimi me ujë të pijshëm vjen kryesisht nga burime natyrore dhe burime ujore nëntokësore, me përjashtim të dy rasteve

¹ ëëë.financa.gov.al Treguesit Kryesorë Makroekonomik 2021


² Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027.

si: zona metropolitane e Tiranës, e cila merr një pjesë të furnizimit të saj nga një burim uji sipërfaqësor në malet ku është ndërtuar një digë për të krijuar një rezervuar artificial, që rrjedhimisht duhet trajtuar; dhe zona turistike e Kavajës e cila merr një pjesë të furnizimit të saj në sezonin veror nga liqeni artificial i Maskurisë, i cili ka krijuar natyrshëm dhe gradualisht një rezervuar sipërfaqësor që duhet të trajtohet.

Burimet ujore në Shqipëri shpërndahen në mënyrë hidrografike në shtatë(7) basene ujore³, të cilat të gjitha rrjedhin në një drejtim perëndimor ose veri-perëndimor në të gjithë vendin dhe kanë si sistemet kryesore të tyre të lumenjve, nga veriu në jug, respektivisht: Lumenjtë Drini-Buna, Lumi Mati, Lumi Ishem, Lumi Erzeni, Lumi Shkumbin, Lumi Semani dhe Lumi Vjosa. Vlen të përmendet se këto sisteme të lumenjve përshkojnë jo vetëm Shqipërinë, por edhe pjesë të mëdha të zonave të banuara të Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Malit të Zi.

³ VKM Nr. 696, datë 30.10.2019 "Për miratimin e kufijve territorialë dhe hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe krijimin dhe përbërjen e këshillit të tyre"

Figura 1-1, Harta e Shqipërisë me 7 Basenet Ujore



Kapaciteti mesatar vjetor i të gjitha burimeve të ujit të përdorura për prodhimin e ujit të pijshëm të shoqërive ujësjellës-kanalizime të monitoruar për vitin 2021 ishte 495 milion metra kub. Referuar raportit vjetor të bilancit vjetor të ERRU-se për vitin 2021, vëllimi i përgjithshëm i ujit të prodhuar ishte 311,2 milion metra kub, ndërsa kërkesa totale e vëllimit të ujit në të gjitha zonat e juridiksionit të shoqërive ujësjellës-kanalizime për vitin 2021 për popullsinë totale (census 2011) ishte 100 milion metra kub.

Bazuar në sa me sipër, uji total i disponueshëm për të gjitha shoqëritë UK tejkalon kërkesën kombëtare nga konsumatorët që ato shërbejnë me rreth 80%. Megjithëse kjo na tregon se kapaciteti ujqor është i mjaftueshëm, bazuar ne raportet Vjetore te Bilancit te Ujit te hartuara nga ERRU, ka dallime të dukshme ndërmjet shoqërive ujësjellës-kanalizime dhe ne raste te veçanta ka disa shoqeri UK per te cilat kerkohen burime te reja shtese te furnizimit me uje. Niveli humbjeve të ujit rezulton të i jetë i lartë në shumicën e shoqërive UK.

1.2 Kuadri Ligjor Aktual që ndikon në Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve

Kuadri ligjor ekzistues synon të përmirësojë performancën e sektorit të ujit duke siguruar bazën ligjore dhe rregullatore të nevojshme për sektorin. Aktualisht, të gjitha shoqëritë ujësjellës kanalizime sh.a. janë riorganizuar në nivel bashkiak dhe rajonal⁴. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) si dhe struktura e saj, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) ushtrojnë një rol të rëndësishëm në procesin e riorganizimit të shërbimeve.

Ligjet kryesore që rregullojnë sektorin e ujit janë si në vijim:

- Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"
- Ligji Nr. 8102, datë 3.03.1996 "Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura"
- Ligji Nr.111, datë 15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujqore"
- Ligji Nr. 9115, datë 24.7.2003, "Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotura"
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare"

Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" është shtylla kryesore për zbatimin e reformave te decentralizimit të qeverisjes vendore. Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre dhe ato të organeve të tyre përkatëse.

Ky ligj përcakton furnizimin me ujë (prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm), ujërat e ndotura (grumbullimi, transportimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura), ujërat e shiut (grumbullimi i ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmytjet në zonat e banuara) dhe mbrojtjen nga zjarri, jane mbi 14 funksione kryesore ekskluzive të bashkive në infrastrukturën dhe shërbimet publike. Ky ligj gjithashtu inkurajon bashkëpunimin midis dy ose më shumë njësive të vetëqeverisjes vendore për të kryer funksione specifike dhe për të ofruar shërbime në funksion dhe në dobi të banorëve të tyre. Ligji përcakton që **"Subjekti i kompetencave të përbashkëta"** është një komitet, entitet, institucion, ndërmarrje ose bord, shoqëri tregtare ose person tjetër juridik, i krijuar nga dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore dhe/ose institucioneve qendrore, me qëllim kryerjen e një shërbimi ose përmbushjen e një detyrimi të përbashkët.

Ligji Nr. 8102, datë 3.03.1996 "Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura", i ndryshuar. Enti Rregullator i Ujit (ERRU) është një institucion publik i pavarur që rregullon sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të përcaktuara me Ligjin 8102, i ndryshuar, për të siguruar mbrojtjen e interesit publik dhe për të krijuar një kuadër rregullator transparent. Enti Rregullator i Ujit ka të drejtën ekskluzive për vendosjen e tarifave dhe licensimin e operatorëve në sektorin e ujit.

⁴ VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura"

Ligji Nr.111, datë 15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore"⁵. Objektivi kryesor i këtij ligji është mbrojtja dhe përmirësimi i burimeve ujore (ujërat sipërfaqësore, ujërat territoriale, ujërat ndërkufitare dhe ujërat nëntokësore) të Republikës së Shqipërisë për përdorimin e qëndrueshëm të këtyre burimeve, si dhe për ndarjen e duhur të këtyre burimeve ujore bazuar në përdorimin dhe qëllimin e synuar. Ligji themeloi organet kombëtare të administrimit dhe menaxhimit të ujit si: Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) dhe Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), ndërkohë menaxhimi i integruar i burimeve ujore në nivel vendor bëhet përmes Këshillave të Baseneve Ujore dhe Zyrat e Menaxhimit të Baseneve Ujore.

Ligji Nr. 9115, datë 24.7.2003, "Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotura"⁶. Ky ligj synon të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga ndikimet negative të ujërave të ndotura, duke përcaktuar gjithashtu rregullat e trajtimit mjedisor dhe detyrimet për shkarkuesit e ndotësve. Objektivat kryesore të zbatimit të këtij ligji janë: ujërat e ndotura urbane, ujërat e ndotura industriale (sipas degëve të veçanta të industrisë), ujërat e kullimit të tokës bujqësore si dhe ujërat e ndotura të çdo lloji.

Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" përcakton rrugën ligjore për trajtimin e bashkimit të shoqërive. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive pjesëmarrëse duhet të përgatisin një "Draft Marrëveshje për Bashkimin" dhe ta paraqesin për miratim në ansamblenë e aksionarëve pasi kanë marrë autorizimet dhe të drejtën e përfaqësimit të njësive vendore nga këshillat bashkiake.

Autoriteti që ka kompetencë të qartë për të vepruar në rast të riorganizimit të një shoqërie i takon Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin funksione dhe kompetenca të përcaktuara sipas kësaj marrëveshje.

Kuadri Kombëtar i Ujit në përputhje me Direktivat e BE-së për ujin e pijshëm dhe ujërat e ndotura⁷

Në përputhje me detyrimet e saj në fushën e ujit dhe si pjesë e objektivit strategjik të Shqipërisë për të hyrë në BE, Qeveria e Shqipërisë ka punuar për të harmonizuar legjislacionin e saj me kuadrin ligjor të BE-së dhe synon të krijojë përgjegjësi të qarta për zbatimin e Acquis të BE. Prandaj, në fushën e cilësisë së ujit ka pasur përparim në drejtim të transpozimit të Direktivës Kuadër të Ujit me miratimin e Ligjit 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore". Transpozimi i Direktivës së Ujit të Pijshëm konsiderohet i realizuar 100% me miratimin e VKM nr. 379, datë 25.05.2016 "Për miratimin e rregullores për cilësinë e ujit të pijshëm".

Ligji Nr. 111/2012 i ndryshuar me ligjin nr. 6/2018, datë 8.2.2018 dhe VKM Nr. 177 datë 31.03.2005 "Për normat e shkarkimeve të lejuara të ujit dhe kriteret e tyre të zonimit në mjedisin ujor të pranuar", ka transpozuar disa nga dispozitat e Direktivës së Trajtimit të Ujrave të Ndotura Urbane. Transpozimi i Direktivës së Trajtimit të Ujrave të Ndotura Urbane kërkon një ndërhyrje serioze si në aspektin ligjor, institucional ashtu edhe në burimet e shumta financiare të nevojshme për të ndërtuar infrastrukturën e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura urbane. Gjithashtu, VKM nr. 127, datë 11.2.2015 "Për kërkesat për përdorimin e llumit të ujërave të ndotura në bujqësi", ka transpozuar pjesën më të madhe të kërkesave të Direktivës së Këshillit 86/278 / KEE të

5 ndryshuar sipas Ligjit Nr.6, datë 8.2.2018

6 ndryshuar sipas Ligjit Nr.34/2013

7 Plani Kombëtar për Integrimin European 2019-2021

12 qershorit 1986, mbi mbrojtjen e tokës kur llumrat e ujërave të ndotura përdoren në mbrojtjen bujqësore të mjedisit, dhe në veçanti të tokës, kur llumrat e ujërave të ndotura përdoren në bujqësi.

Si pjesë e progresit në fushën e administrimit të ujit konsiderohet edhe miratimi i VKM Nr. 993, datë 9.12.2020 "për miratimin e tarifave për përdorimin e ujit, të ujërave ndërkufitare, pagesave administrative të shkarkimit të ujërave dhe ripërdorimit të tyre", ndërkohë Direktiva për Ujërat të Larjes është transpozuar tërësisht me VKM Nr 797, 29.09.2010 "Për miratimin e rregullores higjieno-sanitare për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes".


1.3 Kuadri Institucional dhe Organizativ

Bazuar në VKM nr. 302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", sektori është i organizuar si një sistem me dy nivele. Qeveria qendrore është përgjegjëse jo vetëm për strategjitë sektoriale dhe zhvillimin e politikave, por dhe si bashkëaksionare me qeveritë vendore për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Qeveria qendrore ka rolin parësor të kanalizimit të fondeve të donatorëve dhe të thesarit për investime kapitale, bazuar në vlerësimin e nevojave sipas Master Planeve Kombëtare dhe nevojës që vijnë nga qeveritë vendore/bashkitë. Gjithashtu qeveria qendrore siguron garanci sovrane për huatë nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe mbështet me subvencione operationale për shoqëritë UK, në mbështetje dhe të procesit të riorganizimit të tyre. Siç u përmënd më sipër, Qeveria Shqiptare ka zhvilluar gjithashtu një Strategji Afatgjatë të Financimit për Sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime në Shqipëri, i cili përfshin vendosjen e Objektivave të Politikave Sektoriale Kombëtare dhe vendosjen e investimeve sipas prioriteteve.

Prandaj, kjo pjesë jep një përmbledhje të shkurtër të kuadrit institucional që është aktualisht në fuqi për të organizuar dhe rregulluar shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri.

Figura 1-2, Organizimi ndërinstytucional i reformës së ristrukturimit



Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka si mision të saj hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme shtetërore. MIE është ministria përgjegjëse për Sektorin e Ujësllës Kanalizimeve në Shqipëri dhe përcaktimin e prioriteteve kryesore si:

- zhvillimi dhe zbatimi i Reformës së Sektorit të Ujit;
- sigurimi i asistencës teknike në mbështetje të shoqërive ujësllës kanalizime në kontekstin e ndryshimeve si rezultat i reformës në sektor;

Në maj të vitit 2022, Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit të Infrastruktura dhe Energjisë ka miratuar Vendimin nr. 302 që përcakton politika të reja për ristrukturimin e shoqërive të ujësllës kanalizimeve në vend. Disa nga aspektet kryesore të Vendimit të Këshillit të Ministrave për ristrukturimin e sektorit janë si më poshtë:

- Riorganizimi i shoqërive të ujësllës si Subjekt i Kompetencave të Përbashkëta (SKPUK) do të bëhet nëpërmjet krijimit të shoqërive të reja aksionere, sipas sistemit me dy nivele administrimi në përputhje me përcaktimet në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, shoqëritë të cilave do t'u transferohet veprimtaria ekonomike e shoqërive të ujësllës si pronësi të njësive të qeverisjes vendore që dakordësohen për krijimin e SKPUK.
- Njësitë e qeverisjes vendore që bien dakord për themelimin e SKPUK-së, nënshkruajnë marrëveshjen dhe statutin tip, të cilat shërbejnë si akte themelore për krijimin e SKPUK-së, e cila do të kryejë veprimtarinë e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulon territorin administrativ, sipas hartës territoriale të miratuar nga Agjencia Kombëtare e Ujësllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM).
- SKPUK-ja e themeluar do të ketë në Asamblenë e Aksionarëve përfaqësues të MIE/AKUM të qeverisë qendrore, e cila do të zotërojë të paktën 51% të aksioneve, si dhe përfaqësues të pushtetit vendor brenda Rajonit dhe/ose Rajoneve të ndryshme, të cilat aktualisht kanë në pronësi shoqëritë ekzistuese të ujësllës, aktiviteti i të cilave do të transferohet.

Agjencia Kombëtare e Ujësllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) është njësi ligjore, individuale dhe buxhetore nën MIE. Kjo Agjenci përfaqëson të vetmin institucion teknik të specializuar të Qeverisë në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Detyrat dhe përgjegjësitë e saj kryesore përfshijnë analizën, identifikimin dhe hartimin e politikave, strategjive dhe planeve të veprimit për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve dhe menaxhimit të mbetjeve.

Në kuadër të nismës së Qeverisë Shqiptare për Reformimin e sektorit, AKUM ka autoritetin si aktori më i rëndësishëm përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e reformës dhe strategjisë sektoriale. Procesi i rajonalizimit të 58 shoqërive UK kërkon angazhim të konsiderueshëm të të gjithë strukturave aktuale të AKUM, por edhe të strukturave të reja qeveritare. Duke qënë pjesë integrale aktive e subjektit të kompetencave të përbashkëta, ka rolin primar për të planifikuar dhe zbatuar sic duhet procesin e agregimit në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët kryesore pjesëmarrës në këtë proces. Kjo reformë do të mbështetet nga riorganizimi i Strukturës Organizative dhe funksioneve përgjegjëse të AKUM, për të qënë në linjë me hapat që do të merren për implementimin e reformës.

Enti Rregullator i Ujit (ERRU)

ERRU është një institucion publik i pavarur që rregullon sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për të siguruar mbrojtjen e interesit publik dhe për të krijuar një kuadër transparent rregullator. Funkcionet më poshtë përfaqësojnë funksionet kryesore të ERRU-së:

- Të licencojë të gjithë personat fizikë dhe juridikë që u japin shërbime të furnizimit me ujë dhe / ose ujërave të ndotura për publikun,
- Të sigurojë që ofruesit e shërbimeve ofrojnë shërbime cilësore dhe efikase me një çmim të arsyeshëm,
- Të rregullojë tarifat e shërbimeve në një mënyrë që siguron qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve si dhe përballueshmërinë për konsumatorët.
- Të monitorojë performancën e sektorit UK në përgjithësi dhe të Shoqërive UK në veçanti, si dhe hartimi dhe paraqitja e raporteve vjetore përkatëse pranë Kuvendit të Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave.

Këshilli Kombëtar i Ujit është një autoritet qendror vendimmarrës në fushën e administrimit të burimeve ujore në Republikën e Shqipërisë. Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) është organi kryesor ndërinstitucional i kryesuar nga Kryeministri i Shqipërisë, Zëvendës Kryeministri dhe ministritë e linjës përgjegjëse për hartimin e politikave dhe planeve për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore është autoriteti ekzekutiv i KKU së fundmi i themeluar në Kryeministri dhe është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive që lidhen me burimet e integruara të ujit në Shqipëri, duke siguruar funksionimin dhe monitorimin efektiv të sistemit plotësisht të integruar të ujit në vend. Agjencia luan gjithashtu rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit.

Këshillat e Baseneve Ujore janë ngritur sipas VKM nr. 696, date 30.10.2019 "Për miratimin e kufijve territorialë dhe hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe përbërjen e këshillit të tyre", ndërsa Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore (4) janë ngritur nën Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore. Kryetari i KBU-së përzgjidhet nga prefektura më e madhe e qarkut ku ndodhet baseni ujqor, nënkryetari i KBU-së zgjidhet nga Këshilli i Basenit Ujqor. Sekretari i KBU është njëkohësisht dhe kryetari i Zyrës së Administrimit të Basenit Ujqor. Shqipëria, përta i përket menaxhimit të burimeve ujore, ndahet në shtatë basene ujore, si vijon: Baseni i lumit Drin-Buna; Baseni i lumit Mat; Baseni i lumit Ishëm; Baseni i lumit Erzen; Baseni i lumit Shkumbin; Baseni i lumit Seman dhe Baseni i lumit Vjosa.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Financave (MFE) bazuar në prioritetet e qeverisë, është përgjegjëse për alokimin e burimeve financiare për sektorin e ujit për plotësimin e nevojave të shoqërisë. Ministri i Financave është anëtar i Këshillit Kombëtar të Ujit.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTE) ka përgjegjësinë për të siguruar që të gjitha aspektet mjedisore kryesore të ujit si dhe direktivat e BE-së të transpozohen dhe zbatohen në Shqipëri. Institucioni i kësaj ministrie që luan rol të rëndësishëm në çështjet e ujit është Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në të cilën përfshihet struktura e inspektoratit përgjegjës për ujin si dhe ajo e monitorimit të cilësisë së ujërave.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive në sektorin e kujdesit shëndetësor. Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, Ministria është përgjegjëse për inspektimin dhe monitorimin e cilësisë së ujit

të pijshëm përmes institucioneve të saj si Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSh), Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Instituti i Shëndetit Publik.

Njësitë e Qeverisjes Vendore

Qeveria Shqiptare ka zhvilluar dhe zbatuar me sukses Reformën Administrative Territoriale (RAT) duke riorganizuar qeverisjen vendore në 61 bashki. RAT ka krijuar njësi më të mëdha të qeverive vendore, duke administruar një territor më të madh, të riorganizuar dhe të konsoliduar.

Qeveritë vendore, si bashkepronarë të shoqërive ekzistuese të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve brenda kufijve të tyre administrativ, si dhe e të gjithë infrastrukturës publike të furnizimit me ujë dhe kanalizime në ish komunat që janë bashkuar NJQV të reja, sfidohen për të ofruar shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në territoret e tyre të zgjeruar pas hyrjes në fuqi të Reformës Administrative Territoriale. Në vitin 2016, bashkive ju është dashur të riorganizojnë shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve sipas RAT dhe kërkesës në rritje për shërbime UK.

Procesi i rajonalizimit të shoqërive ekzistuese dhe krijimi i SKP U-K sipas hartës territoriale të hartuar nga AKUM dhe miratuar me VKM nr.302, datë 11.05.2022, kërkoi dhe po merr miratimin nga organet e vetqeverisjes vendore (njvqv), duke nënshkruar marrëveshjet specifike me MIE/AKUM, si dhe kanë marrë konfirmimin ligjor nga Prefektët e qarqeve respektive.


1.4 Situata aktuale dhe Analiza e Performancës së Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve

1.4.1 Organizimi i shërbimeve

Duke u nisur nga Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane”, shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime janë organizuar në shoqëri rajonale UK, të administruara me dy nivele drejtimitë cilat ofrojnë shërbime sipas zonës së shërbimit.

Shoqëritë aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, pas nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të marrëveshjeve të bashkëpunimit, sipas përcaktimit të pikave 1 dhe 2, të VKM për ristrukturimin (maj 2022), po riorganizohen si subjekte me kompetenca të përbashkëta (në vijim “SKP”), të cilat janë shoqëri të reja aksionare të krijuara sipas sistemit të administrimit me dy nivele, në përputhje me formatin e statutin tip, të përcaktuar në lidhjen nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. SKP U-K sh.a.-së i transferohen të gjitha të drejtat, detyrimet, si dhe veprimtaria ekonomike e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësisive të vetëqeverisjes vendore në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për transferimin e aktivitetit të shoqërive ekzistuese tek sh.a Rajonale U-K (SKP-UK), në zbatim të VKM nr.302, datë 11.05.2022, sipas formatit tip Lidhja nr.3 të këtij vendimi.

Figura 1-3: Struktura e Shoqërisë Rajonale



1.4.2 Aksesi në shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve

Gjatë dekadës së fundit mbulimi i furnizimit me ujë është rritur në mënyrë domethënëse në zonat urbane. Mbulimi me kanalizime ka pësuar rritje të lehtë, përkatësisht në zonat urbane ka një rritje më të lartë krahasuar me zonat rurale. Numri i impianteve për trajtim të ujërave të ndotura është rritur në mënyrë të ndjeshme por ka nevojë për përmirësime të dukshme në të ardhmen. Të dhënat janë dinamike dhe analiza krahasimore është relativisht efikase për shkak të reformës sektoriale dhe ndryshimeve të administrimit zonal.

- **Shërbimet për Furnizimin me Ujë**

Mbulimi i përgjithshëm i furnizimit me ujë në nivel kombëtar paraqitet në nivelin 78.06% deri në vitin 2022. Referuar të dhënave nga AKUM gjatë dekadës së fundit ka pasur përmirësim të ndjeshëm lidhur me shërbimin e furnizimit me ujë. Si rezultat i rritjes së investimeve dhe uljes së informalitetit është rritur me 53% numri i kontratave me furnizim

me ujë. Ky tregues duhet përditësuar në vazhdimësi duke marrë në konsideratë investimet në proces dhe ato të planifikuara për t'u implementuar.

- **Shërbimet për Kanalizimet**

Gjatë dekadës së fundit mbulimi i përgjithshëm me kanalizime është përmirësuar gradualisht. Ky përmirësim ka ardhur për shkak të rritjes së mbulimit me kanalizime në zonat urbane, ndërkohë që mbulimi me kanalizime në zonat rurale nuk ka pasur përmirësime të ndjeshme. Bazuar në të dhënat e vitit 2022 shërbimi i kanalizimeve iu ofrohet rreth 74% të konsumatorëve që shërbehen edhe me furnizimin me ujë nga ku 91 % në zonat urbane dhe 26 % në zonat rurale. Si rezultat i rritjes së investimeve dhe uljes së informalitetit është rritur me 46% numri i abonentëve që shërbehen me sistemin e kanalizimeve. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet planifikimit dhe zbatimit të sistemeve individuale të gropave septike në zonat rurale në përputhje me kushtet teknike përkatëse. Këto gropa kryejnë jo vetëm grumbullimin e ujërave të ndotura, por pjesërisht edhe trajtimin e tyre. Aktualisht, nëpërmjet impianteve të trajtimit të ujrave të ndotura trajtohen ujërat e ndotura që gjenerohen nga rreth 27% e numrit total të kontratave të abonentëve. Gjithashtu, ofrohet shërbimi i pastrimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura për një numër i konsiderueshëm të konsumatorëve që kanë gropa septike.

- **Trajtimi i Ujërave të Ndotura**

Qeveria në Shqipëri, në kuadër të mbrojtjes së mjedisit, zhvillimit të turizmit dhe procesit të integritimit në Bashkimin Europian, ka një nga prioritetet kryesore ndërtimin e infrastrukturës të trajtimit të ujërave të ndotura urbane në shkallë vendi ku fokus të veçantë kanë dhe zonat turistike. Referuar të dhënave nga AKUM, aktualisht janë ndërtuar dhe janë në funksionim 12 impiante në zonat urbane dhe turistike si dhe janë në proces ndërtimi 3 impiante të reja. Gjithashtu, janë planifikuar për t'u ndërtuar 2 impiante në zona urbane me potencial zhvillimi turistik.

Sa më sipër, për plotësimin e kërkesave të direktives së trajtimit të ujrave të ndotura urbane, pjesë kjo e procesit të integritimit në Bashkimin Europian, synohet në terma afatgjatë ndërtimi i infrastrukturës së trajtimit të ujrave të ndotura urbane në shkallë vendi.

1.4.3 Cilësia e Shërbimit

- Si rezultat i rritjes së investimeve kapitale është rritur ndjeshëm numri i zonave urbane dhe rurale me furnizim me ujë mbi 20 orë/ditë. Pavarësisht se ky tregues i performancës është rritur në mënyrë të ndjeshme gjatë viteve të fundit, ka endehapësirë për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. **Vazhdimësia e shërbimit**

Vazhdimësia e shërbimit, është vlerësuar mesatarisht rreth 14.9 orë/ditë në të gjithë vendin për vitin 2021. Si rrjedhojë e investimeve të shumta për optimizimin e sistemeve të furnizimit me ujë vitet e fundit rezulton përmirësim në orët e furnizimit me ujë sidomos për zonat urbane ku sipas të dhënave në vitin 2022 janë 33 zona urbane dhe 20 zona rurale me 20 orë/ditë. Gjithsesi, këto shifra theksojnë se vazhdimësia e shërbimit mbetet një sfidë e vërtetë që duhet të adresohet nga shoqëritë UK. Me shtimin e investimeve kapitale për vitet 2023-2025, synohet të sigurohet furnizimi i vazhdueshëm 24 orë/ditë për të gjitha zonat urbane.

- **Cilësia e ujit të pijshëm**

Në vitin 2022, norma mesatare e sigurisë për klorin mbetës ishte 95% dhe 99% për koliformën. Disa shoqëri UK ende po hasin vështirësi në ofrimin e shërbimit me ujë të pijshëm me cilësinë e duhur për konsumatorët e tyre. Si rrjedhojë e investimeve të shumta për optimizimin e sistemeve të furnizimit me ujë, vitet e fundit rezultojnë se krahas përmirësimit të shërbimit nëpërmjet investimeve të kryera në automatizimin e sistemit të furnizimit me ujë dhe dezinfektimit automatik është rritur siguria e cilësisë së ujit. Sigurimi dhe monitorimi i cilësisë krahas automatizimit është shoqëruar gjithashtu edhe me investime në pajisje laboratorike për shoqëritë ujësjellës kanalizime. Si rrjedhojë, është rritur monitorimi i cilësisë së ujit. Në të ardhmen, në kuadër të reformës së ristrukturimit të sektorit synohet plotësimi i infrastrukturës së laboratorëve rajonale në të gjitha shoqëritë e reja të krijuara.

1.4.4 Efiçienca e shërbimeve

1.4.5 Shoqëritë UK përballen me nivele të larta të humbjeve të ujit, si pasojë e amortizimit të rrjeteve dhe nevojës për përmirësim në menaxhim.

Efikasiteti i shërbimit mbetet përgjithësisht i ulët për shkak të nivelit të lartë të ujit pa të ardhura dhe performancës së dobët në drejtim të matjes, faturimit dhe mbledhjes së faturave, eficiencës së stafit dhe efiçencës së energjisë. Duke patur parasysh këtë fakt, nëpërmjet rajonalizimit të shoqërive UK synohet nxitja e një qasje të re për menaxhimin dhe monitorimin e ofrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime. Qeveria shqiptare vlerëson se sfida për të reformuar sektorin ujësjellës kanalizime kërkon instrumente efektive që do të mundësojnë maksimalizimin e të gjithë përpjekjeve për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve.

- **Uji pa të Ardhura (UPA)**

Në vitin 2022, niveli mesatar i ujit pa të ardhura (UPA) për të gjithë sektorin ishte i rreth 63.7 %, shifër ende shumë e lartë, por me një nivel përmirësimi prej 1.5 % krahasuar me të dhënat e viteve paraardhëse. Gjithashtu, niveli i ujit pa të ardhurandryshon shumë nga një shoqëri në tjetrën, duke variuar në vlerat 20% deri 84%.

Të dhënat për llogartijen e UPA-së janë kryesisht vlerësime të përafëruara, duke qenë se mungon matja në puse, në stacionet e pompimit, në rezervuarë dhe rrjetin e shpërndarjes si dhe të nivelit të ulët të matjes tek konsumatorët. Megjithatë, UPA mbetet shumë larg standarteve dhe praktikave me të mira dhe si i tillë, ky tregues është një nga sfidat kryesore që duhet të adresohet për të përmirësuar efikasitetin operacional dhe ekonomik të shoqërive UK.

- **Mbulimi me matje**

Mbulimi me matje për të gjithë konsumatorët familjarë me gjithë përmirësimet e viteve të fundit, mbetet në nivelin rreth 81.6% në 2022. Si e tillë, instalimi i ujëmatëseve në të gjithë sistemin e furnizimit me ujë duhet të mbetet një nga objektivat kryesore të shoqërive UK për të shmangur abuzimet dhe keqpërdorimin e ujit, reduktimin e nivelit të ujit pa të ardhura, përmirësimin e situatës ekonomike të shoqërive.

- **Efiçienca e arkëtimit**

Niveli mesatar i arkëtimit korrent me baze tre-mujore për sektorin UK në vitin 2021 ishte rreth 72.4% dhe ka pësuar përmirësim gjatë dhjetë viteve të fundit pavarësisht luhatjeve vjetore sidomos dy vitet e fundit të lidhura me COVID-19 por edhe me pasojat e tërmetit të shtatorit dhe nëntorit 2019. Norma arkëtimit total në vitin 2021 ishte 108% që përfshin

arkëtime nga faturat korente si dhe arkëtime të detyrimeve të prapambetura. Duke u bazuar në reformën e ndërmarrë pritet që ky tregues të përmirësohet ndjeshëm në të ardhmen.

Gjithashtu, në treguesin e arkëtimit duhet marrë parasysh edhe një kategori e familjeve me statusin e ndihmës ekonomike, të cilët nuk kanë mundësi reale të pagesës për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Qeveria Shqiptare në vitet e ardhshme parashikon të mbështesë sektorin UK nëpërmjet politikave të subvencionimit për këto kategori të shoqërisë.

- **Efiçenca e stafit**

Në vitin 2021, efiçenca e stafit për të gjithë sektorin UK raportohet në 5.8 staf për 1000 lidhje.. Niveli aktual i stafit të shoqërive UK është mbi standardet rajonale dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Gjithashtu lëvizja e stafit menaxherial pengon zhvillimin dhe profesionalizimin e punonjësve dhe mbështetja për politikën për zhvillimin e mëtejshme të kapaciteteve është e nevojshme për të siguruar dhe forcuar ekzistencën e një fuqie punëtore profesionale. Ndaj, Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë një proces për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura urbane për të ofruar një qasje universale, që i plotëson të gjitha kërkesat rregullatore europiane. Monitorimi dhe përmirësimi i këtij treguesi të performancës është vendimtar, pasi kosto e punës përfaqëson zërin kryesor të buxhetit të operimit dhe mirëmbajtjes në shoqëritë UK, duke variuar nga 22 në 81% të OPEX-it dhe mesatarisht 34% në nivel kombëtar. Gjithashtu, ky tregues lidhet dhe me cilësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore brenda shoqërisë UK.

- **Efiçenca e energjisë**

Energjia është një tjetër çështje e rëndësishme e buxhetit të operimit dhe mirëmbajtjes në shoqëritë UK, e cila shkon deri në 80% të OPEX-it total, dhe mesatarisht 36% në nivel kombëtar.

Niveli i lartë i kostos së energjisë por edhe i kostove të tjera, ka sjellë që vit pas viti shoqëritë të kenë vështirësi financiare dhe të akumulojnë detyrime të konsiderueshme ndaj operatorit të furnizimit me energji. Gjatë vitit 2022 situata u përkeqësua me liberalizimin e tregut të furnizimit me energji dhe rritjes së çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët në tension të mesëm. Në këtë kuadër, adresimi i problematikës si pjesë e reformës së sektorit zgjidhi problematikën e çmimit të lartë të energjisë duke aplikuar çmim të rregulluar për shoqëritë ujësjellës kanalizime. Nëpërmjet vendosjes së çmimit të rregulluar gjatë vitit 2023 synohet mbulimi i faturës së energjisë elektrike në masën 95% në nivel sektorial nga 31% që ishte për vitin 2022. Në terma afat-mesëm kjo masë e kombinuar me përmirësimin e menaxhimit dhe uljen e konsumit të energjisë synon mbulimin e faturës së energjisë elektrike në masën 100% në nivel sektorial.

1.4.6 Financat e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve

Situata e vështirë financiare e shoqërive UK e bën pothuajse të pamundur menaxhimin e duhur dhe të qëndrueshëm të aseteve dhe zbatimin e programeve të mëdha të investimeve kapitale.

Të ardhurat nga tarifat përfaqësojnë afërsisht 46% të burimeve të financimit të përgjithshëm të sektorit të ujit në Shqipëri. Subvencionet/Taksat përfaqësojnë 32%, që kryesisht vijnë nga buxheti i shtetit ndërsa trasfertat nga Donatorët e huaj përfaqësojnë deri në 22%.

Gjatë periudhës 2015-2022 burimi kryesor i financimit të sektorit të ujit kanë qënë financimet nga buxheti i shtetit dhe financimi i huaj. Megjithatë ka pasur rritje të tarifave të ujit gjatë dekadës së fundit. Kjo rritje për mjaft shoqëri UK nuk ka qënë në nivelin për të

bërë të mundur mbulimin deri 100% të kostove direkte të O&M. Gjithsesi, tarifat përfaqësojnë burimin kryesor të të ardhurave në mbulimin e kostove të operimit të shoqërive UK. Edhe pse gjatë dekadës së fundit, tarifa e ujit është rritur me 143%, ndërsa tarifa e kanalizimeve është rritur me 218%, tarifa mesatare për konsumatorët familjarë me peshën më të madhe në konsum të ujit dhe të ardhurave është në nivelin 41,66 lekë/m³, e konsideruar e ulët për të mbuluar koston duke sjellë nevojën për rishikim të tarifave.

Si rrjedhojë, shumica e shoqërive UK nuk janë në gjendje të mbulojnë kostot totale të operimit (TOC) për shkak të kombinimit të tarifave të ulëta, nivelit të ulët të arkëtimeve, niveleve të larta të ujit pa të ardhura dhe mungesës së përgjithshme të eficiencës së shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Në vitin 2021, mbulimi mesatar i kostos totale (U+K+ITUN) me arkëtimet arriti në 58.3%. Përveç kësaj, shoqëritë e vogla UK e kanë të vështirë të punësojnë staf të kualifikuar dhe të gjenerojnë burime të mjaftueshme të ardhurash për të siguruar teknologji moderne për operimin dhe mirëmbajtjen e aseteve të sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Për sa më sipër, procesi i rajonalizimit të shoqërive UK synon mundësinë e përmirësimit të ekonomisë së shkallës, rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e nivelit të pagave me qëllim rritjen e interesit ndaj shoqërive ujësjellës kanalizime në tregun e punësimeve. Gjithashtu, në kontekstin e mirëmenaxhimit dhe reduktimit të ujit pa të ardhura, pjesë e planeve të biznesit për shoqëritë e reja rajonale do të jenë edhe planet e ndryshimit të tarifave.

1.4.7 Infrastruktura dhe Investimet në Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve

Sektori i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri është duke u përballur me infrastrukturën e amortizuar si pasojë e nevojave për mbulim me investime për të gjithë sistemet në zonat urbane dhe rurale.

Infrastruktura aktuale në sektorin e ujit mbetet e amortizuar si rezultat i nevojave për investime për të përmbyllur të gjithë sistemet. Për shërbimet e ujësjellësit, asetet fikse për banorë variojnë nga 0 në 157,000 lekë/banorë me një mesatare prej 16,000 lekë/banorë, ndërsa mesatarja për ujërat e ndotura është shumë më e ulët, me 13,000 lekë/banorë dhe shkon nga 0 deri në 359,000 lekë/banor. Kjo do të thotë që kostot e amortizimit dhe kostot e mirëmbajtjes (llogaritur si pjesë e vlerës së aseteve) do të rriten me kalimin e kohës kur infrastruktura e vjetër ekzistuese do të zëvendësohet dhe zgjerohet, duke përkeqësuar mbulimin e kostove operacionale për shërbimet UK.

Niveli i investimeve për periudhën 2017-2022 ka qënë në një mesatare vjetore prej 10.38 miliardë lekë, të ndarë pothuajse në mënyrë relativisht të barabartë midis furnizimit me ujë dhe infrastrukturës së ujërave të ndotura. Në vitet 2020 – 2022 si rezultat i politikës për furnizim me ujë pa ndërprerje për zonat urbane, niveli i investimeve në furnizimin me ujë ka qënë disa herë më i lartë se investimet në infrastrukturën e ujërave të ndotura. Niveli i investimeve varion nga 7 në 15.4 miliardë lekë në vit. Edhe pse niveli i investimeve të realizuara në vite është i lartë, përseri mbulimi i nevojave për investime kapitale mbetet i konsiderueshëm për të arritur mbulimin e plotë me ujësjellës dhe kanalizime në rang kombëtar. Periudha 2019 – 2022 shënon një trend në rritje të investimeve kapitale ku norma e investimeve nga buxheti i shtetit qëndron thuajse në nivele të njëjta me investimet e huaja.

Figura 1-8, Investimet Kapitale në vite, 2017-2022

000/lek								
Emërtimi	Monedha	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Totali
Total Ujesjelles+ kanalizime + Impiante (Financimi I Huaj)	000/lek	6 435 508	3 734 721	5 133 868	2 261 270	2 578 312	1 193 186	21 336 865
Total Ujesjelles+ kanalizime + Impiante (Buxheti I Shtetit)	000/lek	4 187 758	3 380 970	4 139 814	7 904 355	12 910 076	8 428 226	40 951 199
Totali i investimeve Financim I Huaj + Buxhet Shteti	000/lek	10 623 266	7 115 691	9 273 682	10 165 625	15 488 388	9 621 412	62 288 064

Nga analiza e burimeve të financimit dhe destinacionit të investimeve, vlen të theksohet se financimi huaj grant ka qënë i fokusuar kryesisht ne drejtim të ujërave të ndotura ndërsa financimi në kredi ka qënë i fokusuar kryesisht për furnizimin me ujë. Gjithashtu peshë e madhe në investimet për furnizim me ujë kanë qënë financimet nga buxheti i shtetit. Vëmendja e qeverisë vitet e fundit (2019-2022) është përqëndruar kryesisht në investime për të mundësuar furnizimin pa ndërprerje me ujë kryesisht për zonat urbane por pa lene jashtë vëmendjes zonat rurale dhe bregdetare. Gjithashtu projekte të tjera për furnizim me ujë në zonat rurale janë financuar edhe nga donatorë të huaj dhe kryesisht nga qeveria gjermane të zbatuara përmes FSHZH.

Përballueshmëria e tarifave

Përballueshmëria e tarifave në Shqipëri ende nuk përbën problem për shkak të nivelit të tyre të ulët. Megjithatë kjo mund të ndryshojë në të ardhmen nëse tarifat do të rriten për të mbuluar kostot e operimit.

Për shkak të tarifave të ulëta, shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime në Shqipëri mbeten të përballueshme për një përqindje të lartë të popullsisë. Fatura e ujit përfaqëson 2.2% të të ardhurave për një familje me nivel mesatar të ardhurash dhe rreth 2%⁸ të të ardhurave për familjet me të ardhura me të ulëta. Megjithatë ky nivel mbetet nën pragun prej 5%, i cili monitorohet nga ERRU.

1.4.8 Objektivat dhe sfidat kryesore të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve

Në vijim paraqitet një përmbledhje e objektivave dhe sfidave më kritike me të cilat ballafaqohet sot sektori furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Pikerisht nisur nga keto sfida strategjia e re 2023-2030 do të hapë rrugën për të përcaktuar prioritetet e ardhshme kryesore të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Qeverisje, Financime dhe Menaxhim: Financime të pamjaftueshme për të arritur objektivat strategjikë të qeverisë, tarifat e ulëta, angazhimi i pamjaftueshëm dhe jo efektiv i njësive vendore në proceset operacionale dhe planifikuese, mungesa e ekonomisë së shkallës e bëjnë të vështirë për shoqëritë aksionere të furnizimit me ujë dhe kanalizimet për të financuar dhe zbatuar programe madhore të investimeve kapitale. Një nga prioritetet parësore të Qeverisë Shqiptare është reformimi i sektorit UK për një sistem të besueshëm mbarëkombëtar për furnizimin me ujë dhe kanalizime që plotëson nevojat të një ekonomie në zhvillim duke mbrojtur mjedisin, shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve.

Objektivat kryesore të reformës në sektorin e ujesjellës kanalizimeve në Shqipëri janë:

- Përmirësimi i cilësive së shërbimeve për të gjithë popullatën brenda zonës së shërbimeve të shoqërive UK:
 - ✓ Furnizim i pandërprerë me ujë për zonat urbane dhe gradualisht dhe për zonat rurale.
 - ✓ Shërbime të sigurt të grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura.
- Përmirësimi i infrastrukturës së furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në të gjithë territorin.
- Menaxhimi i përmirësuar i kërkesës për ujë.
- Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare për shoqëritë ujësjellës kanalizime:
 - ✓ Harmonizim gradual i tarifave në zonën e shërbimit të shoqërive rajonale sipas ndarjeve në vendimin e qeverisë (maj 2022);
 - ✓ Rritja e faturimeve dhe arkëtimeve në të gjithë zonën e shërbimit.

⁸ Raporti i Performancës 2019, ERRU

- ✓ Hartimi i programit për administrimin e borxhit/kredive:
- Administrimi eficient i borxhit përmes marrëveshjeve të shlyerjes të dakortësuar me konsumatorët debitorë.
- Administrimi eficient i borxhit përmes marrëveshjeve të shlyerjes graduale të dakortësuar me OSHE dhe operatorët e tjerë ekonomik.
- Organizimi i transfertave graduale drejt buxhetit për shlyerjen e stokut të kredive.
- ✓ Rregjistrimi i asetëve të trashëguara nga projektet e infrastrukturës të financuara nga buxheti i shtetit dhe donatorët (IFN).
- ✓ Hartimi dhe implementimi i një programi të integruar për administrimin e asetëve.
- Përmirësimi i njohurive të fuqisë punetore dhe kapaciteteve menaxhuese
 - ✓ Hartimi i strukturave të unifikuara rajonale menaxheriale dhe operacionale;
 - ✓ Alokimi i fondeve në buxhetin vjetor të shoqërisë UK për trajnimin e stafit menaxherial dhe operacional.
 - ✓ Zbatimi i programit të certifikimit të punonjësve të shoqërive UK
- Përmirësimi i qeverisjes dhe kuadrit ligjor/rregullator të sektorit:
 - ✓ Harmonizimi i kuadrit ligjor kombëtar të sektorit UK në përputhje me direktivat e BE për ujën e pijshëm, ujrat e ndotura, të llumrave aktive të impianteve të trajtimit të ujrave të ndotura, të emetimit zero, dhe të ekonomisë qarkulluese.

PJESA II: VIZIONI, MISIONI DHE QËLLIMET E POLITIKËS

Në një botë që ndryshon çdo ditë e më shumë, Sektori i Shërbimeve Ujësjellës dhe Kanalizimeve duhet të jetë një sektor i qëndrueshëm dhe i besueshëm. Një ndër prioritetet e Qeverisë Shqiptare është ofrimi i shërbimeve të avancuara të furnizimit me ujë dhe kanalizime si dhe menaxhimi i integruar i ujit në lidhje me zhvillimin ekonomik.

Kjo është arsyeja pse Strategjia Kombëtare thekson veprimet që duhen ndërmarrë për të trajtuar njerëzit dhe mjedisin si pasuritë më të mëdhaja.

Në zbatim të kësaj Strategjie, investimet në sektorin e shërbimeve ujësjellës kanalizime mund të jenë një mjet ndihmues për rritjen e shpejtë ekonomike, zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e shëndetit të qytetarëve shqiptarë. Prandaj, uji konsiderohet si një sektor ekonomik i rëndësishëm për Shqipërinë.

2 Vizioni

Deklarata e Vizionit është një mesazh i thjeshtë por i fuqishëm që përshkruan punën e madhe për ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime si shërbime thelbësore dhe kritike për jetën e njeriut. Deklarata e kësaj Strategjie Sektoriale përcakton drejtimin ku do të fokusohen investimet duke synuar cilësinë më të lartë të shërbimeve për periudhën 2023-2030.

VIZIONI

Një sistem i besueshëm mbarë kombëtar për furnizimin me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura që plotësojnë nevojat për zhvillimin ekonomik dhe të shoqërisë në përgjithësi, duke ruajtur dhe mbrojtur mjedisin, shëndetin dhe sigurinë e popullsisë në Republikën e Shqipërisë.

2.1 Misioni i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime

Bazuar në aspiratat e qeverisë shqiptare për zbatimin e direktivave të BE-së, Deklarata e Misionit pasqyron qëllimin themelor të kësaj Strategjie.

DEKLARATA E MISIONIT

Hartimi i politikave të përshtatshme dhe angazhimi i fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura, dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e Bashkimit Europian dhe me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Deklarata e Misionit për këtë Strategji Sektoriale shërben për të përqendruar nismat e Qeverisë në gjashtë objektivat strategjike kyçe që duhet të adresohen, si në politika ashtu edhe në veprime, për të arritur përmirësimin e dëshiruar në shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

2.2 Parimet Kryesore të Strategjisë së Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime

Strategjia e Sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizime mund të përcaktojë kushtet që duhen plotësuar si dhe mund të shërbejë si bazë për arritjen e Parimeve Kryesore të sektorit.

PARIMET KRYESORE TË STRATEGJISË SË SEKTORIT

QËNDRUESHMËRI	Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime duhet të jenë ekologjikisht, teknikisht dhe financiarisht të qëndrueshëm përmes mbulimit të plotë të kostos .
PËRPUTHSHMËRI	Sektor i furnizimit me ujë dhe kanalizime ofron qasje universale që i plotëson të gjitha kërkesat rregullatore / europiane sipas parimit ndotësi pagan .
EFIÇIENCË	Shoqëritë e furnizimit me ujë dhe kanalizime të kenë efikasitet dhe performancë të cilësisë së shërbimit të barabartë me praktikën e mirë evropiane dhe sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese.

PËRBALLUESHMËRI	Të sigurohet ofrimi i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për konsumatorët me një çmim të përballueshëm .
TRANSPARENÇË	Të sigurohet pjesëmarrja e publikut dhe transparenca në politikat e ujit.

2.3 Qëllimet e Politikës dhe Rezultatet / Masat Prioritare

Vizioni Misioni, Qëllimet e Politikës dhe Rezultatet / Masat Prioritare të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime janë paraqitur grafikisht në Figurën 2-1. Masat Prioritare do të shtjellohen më tej në aneksin 1 të Strategjisë duke përfshirë përcaktime si specifike, të matshme dhe afatet kohore.

Figura 2-1, VIZIONI – MISIONI – QËLLIMET E POLITIKËS – REZULTATET / MASAT PRIORITARE

VIZIONI					
Një sistem i besueshëm mbarë kombëtar për furnizimin me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura që plotësojnë nevojat për zhvillimin ekonomik dhe të shoqërisë në përgjithësi, duke ruajtur dhe mbrojtur mjedisin, shëndetin dhe sigurinë e popullsisë në Republikën e Shqipërisë.					
MISIONI					
Hartimi i politikave të përshtatshme dhe angazhimi i fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura, dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e Bashkimit Europian dhe me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.					
Qëllimi i Politikës 1	Qëllimi i Politikës 2	Qëllimi i Politikës 3	Qëllimi i Politikës 4	Qëllimi i Politikës 5	Qëllimi i Politikës 6
Zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit në sistemet e furnizimit me ujë për popullsinë.	Zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit në sistemet për grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura për popullsinë.	Zbatimi i programit për riorganizimin e shërbimeve UK në baza rajonale.	Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare dhe përballueshmërisë së shërbimeve UK sipas parimeve të kontrollit dhe mbulimit të plotë të kostove operacionale.	Rritja e kapaciteteve dhe miradministrimi i shërbimeve UK.	Permiresimi dhe perditesimi i kuadrit ligjor, rregullator që mundëson ofrimin e shërbimeve UK për popullsinë.
REZULTATET / MASAT PRIORITARE	REZULTATET / MASAT PRIORITARE	REZULTATET / MASAT PRIORITARE	REZULTATET / MASAT PRIORITARE	REZULTATET / MASAT PRIORITARE	REZULTATET / MASAT PRIORITARE
Identifikimi dhe raportimi i treguesve tekniko – financiar për shoqëritë SPKUK <u>Rezultatet e parashikuara:</u> <i>Proçeset e Identifikimit për vitin 2023: Matja e saktë e sasisë së ujit në prodhim për zonat urbane. Matja e saktë e sasisë së ujit në prodhim për zonat rurale. Vlerësimi i humbjeve teknike dhe administrative. Vlerësimi i saktë i zonës së mbulimit me ujë dhe kanalizime të ndarë në zona urbane / rurale. Identifikimi i mbulimit të Kostove O&M me Arkëtimet Identifikimi i Arkëtimeve Korente dhe Totale</i>	Rritja e aksesit të popullsisë të lidhur me sistemin e grumbullimit dhe largimit të ujrave të ndotura. <u>Rezultatet e parashikuara:</u> <i>Mbulimi me sistemin e grumbullimit dhe largimit të ujrave të ndotura: Plani deri në 2025: 55.5 % Plani deri në 2030: 65.5 %</i>	Zhvillimi I një programi të bashkërenduar me NJQV për riorganizimin e të gjithë shoqërive egzistuese UK në shoqëri rajonale si Subjekte të Kompetencave të Perbashkëta UK. <u>Rezultatet e parashikuara:</u> <i>Plani deri në 2025: 15 shoqëri rajonale janë krijuar dhe rregjistruar në QKB.</i>	Mbulimi i kostove të mirëmbajtjes, dhe shpenzimeve kapitale për riparime dhe zëvendësime. <u>Rezultatet e parashikuara:</u> <i>Plani deri në 2025: Mbulimi i Kostos Totale në masën 72% Plani deri në 2030: Mbulimi i Kostos Totale në masën 95%</i>	Hartimi i një platforme dhe mekanizimave për zhvillimin e njohurive dhe trajnimeve për të gjithë aktorët sektorialë në nivel qendror dhe lokal. <u>Rezultatet e parashikuara:</u> <i>Plani deri në 2024: Plani kombëtar i hartuar për zhvillimin e kapaciteteve në nivel qendror rajonal dhe lokal. Plani deri në 2027: Platforma për zhvillimin e kapaciteteve funksionale dhe e administruar nga AKUM.</i>	Përmirësimi dhe zgjerimi i akteve ligjore dhe rregullatore të nevojshme për të lehtësuar procesin e riorganizimit të shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura, në baza rajonale. <u>Rezultatet e parashikuara:</u> <i>Plani afatshkurtër deri 2024: Miratim i standarteve të shërbimit për shoqëritë rajonale UK dhe përgatitja e bazës ligjore që i jep mundësi qeverise te nderhyje ne sktor duke marre drejtimin e shoqerive te cilat nuk lotesojne standardet e licensimit ose operojne per me shume se 2 vite te njepasnjeshme me kapital negativ. Plani afatmesëm deri në 2027: Aktet e nevojshme rregullatore përkatësisht për licensimin, vendosjen e tarifave, rregullave</i>

					uniforme etj, jane plotësisht efektive në funksion të aktivitetit për ofrimin e shërbimeve.
<p>Rritja e aksesit të popullsisë në sistemet e furnizimit me ujë të sigurt e cilësor.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p>Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë:</p> <p>Plani deri në 2025: 82 % Plani deri në 2030: 90 %</p>	<p>Rritja e aksesit të popullsisë të lidhur me një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p>Mbulimi me sistemin e trajtimit të ujërave të ndotura:</p> <p>Plani deri në 2025: 16.5 % Plani deri ne 2030: 25 %</p>	<p>Ristrukturimi dhe reformimi rrënjësor i institucioneve qendrore në funksion të zbatimit të programit për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në baza rajonale.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p>Plani deri në 2023: Struktura e re e AKUM e miratuar nga KM dhe e plotësuar me stafin dhe infrastrukturën e nevojshme</p> <p>Plani deri ne 2025: AKUM akreditohet për të të administruar fonde të BE_se për infrastrukturën e furnizimit me ujë dhe kanalizimet.</p> <p>Plani deri ne 2030: AKUM, qënder ekselence dhe inovacioni për administrimin e shërbimeve dhe teknologjinë e Informacionit.</p>	<p>Zhvillimi dhe unifikimi gradual i tarifave sipas zonave rajonale të shërbimit, për të mundësuar gradualisht, mbulimin e plotë të kostove duke synuar mbrojtjen e konsumatorët me të ardhura të ulta.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p>Plani deri në 2024: Harmonizimi i tarifave te ujit dhe kanalizimeve për 5 Shoqëri Rajonale sipas metodologjisë se përcaktuar nga ERRU.</p> <p>Plani deri në 2027: Harmonizimi i tarifave te ujit dhe kanalizimeve për 15 Shoqëri Rajonale sipas metodologjisë se përcaktuar nga ERRU.</p>	<p>Zbatimi i vazhdueshëm i programit për trajnimin e punonjësve të shoqërive rajonale UK për rritjen e kapaciteteve profesionale, forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e eksperiencave mes tyre.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p>Plani afatshkurtër deri në 2024: 1 % e fondit të pagave do të alokohet për trajnimin e vazhdueshem të personelit në nivel qendror, rajonal dhe lokal.</p> <p>Plani afatmesëm deri në 2027: 1.5 % e fondit të pagave do të alokohet për trajnimin e vazhdueshem të personelit në nivel qendror, rajonal dhe lokal.</p> <p>Plani afatgjatë deri në 2030: 2 % e fondit të pagave do të alokohet për trajnimin e vazhdueshem të personelit në nivel qendror, rajonal dhe lokal.</p>	<p>Hartimi i ligjit te ri sektorial për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura, me qëllim ngritjen e mekanizmave për bashkërendimin e politikave dhe përgjegjësi të aktorëve kryesorë sektorialë.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p>Plani deri 2024: Miratim në parlament i projektligjit për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.</p> <p>Plani deri në 2027: Miratim dhe zbatim i aktet ligjore dhe nënligjorë në zbatim të ligjit për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.</p>

<p>Rritja e orëve të furnizimit me ujë për popullsinë në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërive rajonale UK.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p>Orët e furnizimit me ujë:</p> <p>Plani deri në 2025: 18 orë/ditë Plani deri në 2030: 24 orë/ditë</p>		<p>Ngritja e një sistemi për monitorimin dhe vlerësimin e ecurisë dhe impaktit të zbatimit të procesit për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në baza rajonale.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p>Plani deri në 2024: Sisteme i monitorimit dhe vlerësimit i ngritur brenda AKUM dhe funksional Plani deri në 2027: Raporte vjetore per monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit në cilësinë e shërbimeve dhe qëndrueshmërinë financiare.</p>	<p>Rritja e nivelit të arkëtimit, duke synuar zbatimin e praktikave më të mira ndërkombëtare.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p>Plani deri në 2025: Niveli arkëtimit korrent: 90% Plani deri në 2030: Niveli arkëtimit korrent: 100%</p>	<p>Zbatimi i programit kombëtar të çertifikimit sipas objektivave që janë përcaktuar për secilën shoqëri rajonale UK.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p>Plani afatshkurtër deri në 2024: Manuali i rishikuar për trajnimin dhe çertifikimin e punonjësve të shoqërive rajonale UK. Plani afatmesëm deri në 2027: Programi i çertifikimit funksional dhe i administruar nga AKUM. Plani afatgjatë deri në 2030: Stafi administrues dhe operues i çdo shoqërie rajonale është i trajnuar dhe çertifikuar.</p>	<p>Harmonizimi i kuadrit ligjor kombëtar për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në përputhje me direktivat e BE për ujin.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p>Plani deri në 2024: VKM për përafrimin e legjisllacionit me direktivën për trajtimin e ujrave të ndotura urbane. Plani deri në 2027: Përputhje e plotë e legjisllacionit shqiptar për ujin me direktivat e BE. Plani deri në 2030: Zbatimi i plotë i legjisllacionit dhe monitorimi.</p>
<p>Hartimi i planeve për përdorimin e ujit me efikasitet në të gjithë sektorët, duke siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe duke rritur ndjeshëm ripërdorimin e tij sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p>Plani deri në 2025: Rregullore për ripërdorimin e ujit; Plani deri në 2027: 3 shoqëri rajonale UK zbatojnë planin sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese. Plani deri në 2030: Model efektiv ekonomik për ofrimin dhe administrimin e shërbimeve UK sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese.</p>		<p>Vlerësimi i efekteve të agregimit të shoqërive dhe vijimi i procesit.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u> Plani afatshkurtër deri në 2024: Vlerësimi i efekteve të procesit të agregimit në performancën e sektorit. Plani afatmesëm deri në 2027: Te vlerësohet nga AKUM mundësia për të vijuar procesin e ristrukturimit të sektorit duke kaluar në një fazë tjetër agregimi për uljen e metejshme të numrit të shoqërive ose krijimi i një modeli të ri tregu ku të përfshihet ndarja dhe specializimi i shoqërive sipas funksioneve, prodhim teknike, komerciale ose</p>	<p>Përmirësimi i sistemit të faturimit dhe instalimi i sistemit të pagesave online për konsumatorët.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p>Plani deri në 2024: Sistem i unifikuar i faturimit në të gjithë shoqëritë rajonale (50%) Plani deri në 2027: Leximi (aksesi) online i faturës nga konsumatorët për të gjithë shoqëritë rajonale UK. Plani deri në 2030: Sistemi i pagesës online për të gjithë shoqëritë rajonale UK.</p>	<p>Implementimi i një strukture re eficiente të unifikuar për shoqëritë rajonale UK.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u> Plani deri në 2023: Strukturë e unifikuar dhe e miratuar në të gjithë shoqëritë rajonale UK.</p>	<p>Hartimi dhe Zbatimi i Paketave të Ndërgjegjësimit dhe Informimit për Qytetarët.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u> Plani afatshkurtër deri në 2024: Plani kombëtar për informimin dhe ndërgjegjësimin. Plani afatmesëm deri në 2027: Platformë vjetore për organizimin e fushatave sensibilizuese në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.</p>

		perfshirja e operatoreve privat.			
<p>Hartimi dhe zbatimi i planeve rajonale për reduktimin i nivelit të Ujit Pa të Ardhura.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u> Uji pa të ardhura:</p> <p>Plani deri në 2025: 60 % Plani deri në 2030: 45%</p>			<p>Hartimi dhe zbatimi efektiv i nje sistemi te unifikuar te menaxhimit dhe mirembajtjes se asetëve per shoqëritë rajonale UK.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p>Plani deri në 2025: Standarte të unifikuar për vlerësimin të asetëve në të gjithë shoqëritë rajonale UK</p> <p>Plani deri në 2027: Sistemi i digjitalizuar për administrimin e asetëve funksional në 10 shoqëri rajonale UK.</p> <p>Plani deri në 2030: Sistemi i digjitalizuar për administrimin e asetëve funksional në të gjithë shoqëritë rajonale UK.</p>	<p>Hartimi dhe zbatimi i një plani të detajuar për transformimin dixhital dhe i një qasjeje të integruar për sigurinë kibernetike për administrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p>Plani afatshkurtër deri në 2024: Plan dhe buxhet i vënë në dispozicion për infrastrukturën TIK dhe trajnimet e nevojshme sipas axhendes kombetare për digjitalizimin e shërbimeve për furnizimin me ujë dhe kanalizime.</p> <p>Plani afatmesëm deri në 2027: Platforma digjitale per administrimin e shërbimeve në nivel qendror, rajonal dhe lokal, që ndërveprojnë në menyrë efektive.</p> <p>Plani afatgjatë deri në 2030: 80% e sistemeve infrastrukturore për furnizimin me ujë dhe</p>	<p>Zbatimi I mekanizmave për forcimin dhe përfshirjen gjinore, si dhe të pjesëmarrjes së komuniteteve lokale, në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p>Plani afatshkurtër deri në 2024: Studimi kombëtar për barazinë gjinore në sektorin e ujit.</p> <p>Plani afatmesëm deri në 2027: Përqindja e përfaqësimit të grave në Këshillat Mbikqyrës është 50%.</p> <p>Plani afatgjatë deri në 2030: Platformë funksionale komunikimi dhe përfaqësimi të njëjve dhe komuniteteve lokale në proceset e planifikimit dhe miradministrimin e shërbimeve.</p>

				kanalizimet, të automatizuara.	
<p>Përmirësimi i cilësisë së ujit të pijshëm.</p> <p><i>Rezultatet e parashikuara:</i></p> <p><i>Plani deri në 2025: Ngritja e 15 laboratorëve rajonale në shoqëritë UK rajonale për cilësinë e ujit.</i></p> <p><i>Plani deri në 2030: Zbatimi i Planeve për Sigurinë e Ujit të Pijshëm nga të gjitha shoqëritë rajonale UK</i></p>			<p>Implementimi i një qasje të re në investimet në sektor drejt reduktimit të konsumit të energjisë nga shoqëritë rajonale UK, nëpërmjet investimeve për furnizimin me energji nga fotovoltaiket, vendosjes se pompave sipas kriterëve të BE dhe instalimi i programit SCADA që rrit efektshmerine e tyre.</p> <p><u>Rezultatet e parashikuara:</u></p> <p><i>Plani afatshkurtër deri në 2024: Plani për efikasitetin e energjisë për të gjithë shoqëritë rajonale UK.</i></p> <p><i>Plani deri në 2025: Ndërtimi i sisteme alternative për furnizimin me energji elektrike për 5 shoqëri rajonale UK.</i></p>		

			<i>Plani deri në 2030: Programi për efektivitetin e energjisë funksional në të gjithë shoqëritë rajonale UK.</i>		
--	--	--	--	--	--

2.4 Politikat Strategjike në Mbështetje të Masave Prioritare për Sektorin

Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime është një dokument i rëndësishëm që do të orientojë Qeverinë në përpjekjet e saj në përmirësimin e sektorit UK. Nga Grupi i Punës Ndërministror ato janë përcaktuar duke u bazuar dhe në Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm, Qëllimi 6 (SDG6) që është:

Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujit dhe kanalizimeve për të gjithë.

Objektivat e përcaktuar për arritjen e këtij qëllimi janë:

6.1 Deri në vitin 2030, të arrihet akses universal dhe i barabartë në ujë të pijshëm dhe të sigurtë për të gjithë.

6.2 Deri në vitin 2030, të arrihet akses në kanalizime dhe higjienë adekuate dhe të barabartë për të gjithë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të grave dhe vajzave dhe ata që janë në situata të cënueshme.

Në mënyrë Strategjia parashikon (6) gjashtë Qëllime të Politikës të cilat janë specifike, të matshme dhe me afate kohore të përcaktuara.

Më tej, këto gjashtë Qëllime të Politikës janë përkthyer në Rezultate / Masa Prioritare të cilat do të detajohen nëpërmjet Planeve të Veprimit. Secila Masë Prioritare është shoqëruar me një objektivi të caktuar të performancës që do të arrihen në afatet kohore të parashikuara dhe do të monitorohen gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kësaj Strategjie.

Tabela 2-1 paraqet Qëllime të Politikës dhe rezultatet e parashikuara të performancës për secilën masë prioritare, së bashku me vlerat e indikatorëve të performancës për secilin vit të periudhës së planifikimit të Strategjisë. Pashaportat e detajuara të indikatorëve jepen në aneksin 3 të strategjisë.

Për të vendosur një referencë, si vit bazë është marrë 2021. Duke përdorur vlerat vjetore të vitit bazë për Treguesit e Performancës, Grupi i Punës Ndërministror, i cili ishte përgjegjës për zhvillimin e Strategjisë Sektoriale, përcaktoi një vlerë të arritshme për Treguesin e Performancës për vitin e fundit të periudhës së planifikimit, 2023-2030, si dhe vlerat e ndërmjetme për secilin nga 8 vitet e periudhës së planifikimit.

Këto tregues të parashikuara për secilën masë prioritare janë elementë kryesorë për të monitoruar, vlerësuar dhe raportuar progresin në zbatimin Strategjisë në termat kohore (2023-2025), dhe (2026-2030). Ato gjithashtu do të përdoren për të identifikuar çdo devijim në mes të performancës së parashikuar dhe arritjeve aktuale vjetore në terren dhe si rrjedhim të përcaktojnë veprimet korrigjuese dhe të përditësojnë Strategjinë kur është e nevojshme. Procesi i monitorimit, raportimit dhe përditësimit të Strategjisë është detajuar më tej në Pjesën e IV.

Tabela 2-1
Objektivat Strategjike dhe Indikatorët e Performancës

Nr	Objektivat Strategjike/Masat Prioritare	Viti Baze 2021	Plani Viti 2022	Plani Viti 2023	Plani Viti 2024	Plani Viti 2025	Plani Viti 2026	Plani Viti 2027	Plani Viti 2028	Plani Viti 2029	Plani Viti 2030
	Pershkrimi i Objektivit										
1	Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit të furnizimit me ujë										
1.1	Mbulimi me Ujesjelles (Niveli Kombetar)	77.7%	78.3%	79.7%	80.8%	82.0%	83.5%	85.1%	87.7%	88%	90%
1.1.1	Mbulimi me Ujesjelles per zonat urbane	92.0%	93.0%	94.0%	94.5%	95.0%	95.5%	96.0%	97.0%	98.0%	99.0%
1.1.2	Mbulimi me Ujesjelles per zonat rurale	57.9%	58.0%	60.0%	62.0%	64.0%	67.0%	70.0%	75.0%	80.0%	85.0%
1.2	Vazhdimësia e Furnizimit me Uje (ore/dite)	15	15.5	16	17	18	19	20	21	22.5	24
1.2.1	Vazhdimësia e Furnizimit me Uje (ore/dite) Qytet	16	17	18	19	20	21	22	23	24	24
1.2.2	Vazhdimësia e Furnizimit me Uje (ore/dite) Fshat	12	13	14	15	16	17	18	19	20	24
1.3	Hartimi i planeve për përdorimin e ujit me efikasitet në të gjithë sektorët, duke siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe duke rritur ndjeshëm ripërdorimin e tij sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese.	-	-	5.0%	10.0%	20.0%	30.0%	45.0%	60.0%	80.0%	100.0%
1.4	Reduktimi i Ujit pa të Ardhura	65.4%	64.0%	63.0%	62.0%	60.0%	57.0%	52.0%	50.0%	48.0%	45.0%
1.4.1	Niveli i matjes se konsumit te ujit shprehur ne numer lidhjesh	78.4%	80.0%	82.0%	85.0%	87.0%	90.0%	93.0%	95.0%	97.0%	100.0%
1.5.1	Sisteme automatike të dezinfektimit të ujit të pijshëm për të gjitha shoqëritë rajonale UK	-	-	30%	50%	70%	90%	100%	100%	100%	100%
1.5.2	Ngritja e Laboratoreve Rajonal per Cilesine e Ujit te Pijshem (15)	-	-	30%	50%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
1.5.3	Plane per Sigurine e Ujit te perfunduara per te gjitha Shoqerite UK te Licensuara	-	-	30%	40%	60%	70%	80%	90%	100%	100%
2	Pershkrimi i Objektivit										

	Zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit në sistemet për grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura për popullsinë.										
2.1	Mbulimi me Kanalizime (Niveli Kombëtar)	53.0%	53.5%	54.0%	54.5%	55.3%	56.8%	58.8%	60.8%	62.8%	64.8%
2.1.1	Mbulimi me Kanalizime për zonat urbane	82.4%	83.0%	83.5%	84.0%	84.5%	85.0%	87.0%	89.0%	91.0%	93.0%
2.1.2	Mbulimi me Kanalizime për zonat rurale	12.6%	13.0%	13.5%	14.0%	15.0%	18.0%	20.0%	22.0%	24.0%	26.0%
2.2	Mbulimi me Trajtim të Ujrave të Përdorura nga ITUP	14.4%	15.0%	15.5%	16.0%	16.5%	18.0%	20.0%	22.0%	24.0%	26.0%
3	Pershkrimi i Objektivit										
	Zbatimi i programit për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në baza rajonale.										
3.1	Zhvillimi i një programi të bashkënduar me NJQV për riorganizimin e të gjithë shoqërive egzistuese UK në shoqëri rajonale si Subjekte të Kompetencave të Përbashkëta UK.	-	67%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
3.2	Ristrukturimi dhe reformimi rrënjësor i institucioneve qendrore në funksion të zbatimit të programit për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në baza rajonale.	-	30.0%	40.0%	50.0%	60.0%	70.0%	80.0%	90.0%	100.0%	100.0%
3.3	Ngritja e një sistemi për monitorimin dhe vlerësimin e ecurisë së zbatimit të procesit për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në baza rajonale.	-	-	50.0%	70.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
3.4	Vlerësimi i efekteve të agregimit të shoqërive dhe vijimi i procesit							100%	100%	100%	100%
4	Pershkrimi i Objektivit										
	Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare dhe përbalueshmërisë së shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura sipas parimeve të kontrollit dhe mbulimit të plotë të kostove operacionale.										

4.1.1	Mbulimi i Kostove te Operimit dhe Mirembajtjes (O&M) me Arketimet Korente	80.0%	85%	90%	95%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
4.1.2	Mbulimi i Kostove Totale te Operimit (KTO perfshire shpenzimet per shlyerjen e kredive dhe fondet per rezervat kapitale) me Arketimet Korente	58.3%	60%	64%	68%	72%	75%	80%	85%	90%	95%
4.2	Tarifë e unifikuar per shoqëritë rajonale UK	-	-	35.0%	70.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.3.1	Norma e Arkëtimit Korent	72.4%	75.0%	77.0%	85.0%	90.0%	93.0%	96.0%	99.0%	100.0%	100.0%
4.4.1	Sistem i unifikuar i faturimit në të gjithë shoqërite rajonale UK	-	-	50.0%	75.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.4.2	Leximi (aksesi) online i faturës për të gjithë shoqëritë rajonale UK.	-	30.0%	50.0%	75.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.4.3	Sistemi i pagesës online për të gjithë shoqëritë rajonale UK.	-	-	20.0%	30.0%	40.0%	50.0%	60.0%	80.0%	90.0%	100.0%
4.5.1	Standarte të unifikuar për vlerësimin të aseteve në të gjithë shoqërite rajonale UK.	-	-	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.5.2	Sistemi i digjitalizuar për administrimin e aseteve funksional në shoqëritë rajonale UK.	-	20.0%	40.0%	60.0%	70.0%	80.0%	90.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.6.1	Plani për eficensën e energjisë për të gjithë shoqëritë rajonale UK.	-	-	20.0%	50.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.6.2	Ndërtimi i sisteme alternative për furnizimin me energji elektrike për 5 shoqëri rajonale UK.	-	-	20.0%	50.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
4.6.3	Programi për eficensën e energjisë funksional në të gjithë shoqëritë rajonale UK.	-	-	20.0%	35.0%	50.0%	60.0%	70.0%	80.0%	90.0%	100.0%
5	Pershkrimi i Objektivit										
	Rritja e kapaciteteve dhe miradministrimi i shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.										

5.1.1	Plani kombëtar i hartuar për zhvillimin e kapaciteteve në nivel qëndror rajonal dhe lokal.	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
5.1.2	Platforma për zhvillimin e kapaciteteve funksionale dhe e administruar nga AKUM.	-	-	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%
5.2	Rritja e Buxhetit të alokuar për trajnimin e Stafit të Shoqërive UK (e shprehur si % e buxhetit total të pagave)	-	-	1.0%	1.2%	1.4%	1.5%	1.5%	1.7%	1.8%	2.0%
5.3.1	Manuali i rishikuar për trajnimin dhe çertifikimin e punonjësve të shoqërive rajonale UK.	-	-	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
5.3.2	Programi i çertifikimit funksional dhe i administruar nga AKUM.	-	-	-	-	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
5.3.3	Stafi administrues dhe operues i çdo shoqërie rajonale është i trajnuar dhe çertifikuar.	-	-	-	30%	60%	80%	100%	100%	100%	100%
5.4	Strukturë e unifikuar dhe e miratuar në të gjithë shoqëritë rajonale UK.	-	20.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
5.5.1	Plan dhe buxhet i vënë në dispozicion për infrastrukturën TIK dhe trajnimet e nevojshme sipas axhendes kombetare për digjitalizimin e shërbimeve për furnizimin me ujë dhe kanalizime.	-	-	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
5.5.2	Platforma digjitale për administrimin e shërbimeve në nivel qëndror, rajonal dhe lokal, që ndërvepron në menyrë efektive.	-	-	-	-	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%
5.5.3	Sistemeve infrastrukturore për furnizimin me ujë dhe kanalizimet, të automatizuara.	-	-	10.0%	20.0%	30.0%	40.0%	50.0%	60.0%	70.0%	80.0%
6	<i>Pershkrimi i Objektivit</i>										
	Përmirësimi i qeverisjes dhe kuadrit ligjor/rregullator të sektorit										

6.1.1	Miratim i standarteve të shërbimit për shoqërite rajonale UK.	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.1.2	Aktet e nevojshme rregullatore përkatësisht për licensimin, vendosjen e tarifave, rregullave uniforme etj, janë plotësisht efektive në funksion të aktivitetit për ofrimin e shërbimeve.	-	-	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.2.1	Miratim në parlament i projektligjit për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.	-	80%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.2.2	Miratim dhe zbatim i aktet ligjore dhe nënligjorë në zbatim të ligjit për shërbimet e furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura.	-	-	-	50%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.3	Perfundimi i procesit të harmonizimit të kuadrit ligjor kombëtar të sektorit UK në përputhje me direktivat e BE për ujin	-	-	-		100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.4.1	Plani kombëtar për informimin dhe ndërgjegjësimin.	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.4.2	Platformë vjetore për organizimin e fushatave sensibilizuese në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.	-	-	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.5.1	Studimi Kombëtar për të adresuar Barazime Gjinore	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.5.2	Përqindja e përfaqësimit të grave në Këshillat Mbikqyrës është 50%.	-	-	-	-	100%	100%	100%	100%	100%	100%
6.5.3	Platformë funksionale komunikimi dhe përfaqësimi të njësive dhe komuniteteve lokale në proceset e planifikimit dhe miradministruimit të shërbimeve.	-	-	-	10%	30%	50%	70%	80%	90%	100%

Pjesa III: Projektet/Programet kombëtare të zhvillimit për zbatimin e strategjisë

3 Investimet mbështetëse të politikave strategjike; PBA 2023-2025

Në /000 Lekë

Grupi	Emertimi Institucionit	Programi	Emertimi I Projektit	Statusi I Projektit	Viti I fillimit	Viti I perfundimit te financimit	Burimi I Financimit	Vlera Totale e projektit	Financimi deri ne 31.12.2021	Buxheti Plan 2022	Parashikimi per v. 2023	Parashikimi per v. 2024	Parashikimi per v. 2025
			TOTAL FINANCIM I BRENSHEM DHE FINANCIM I HUAJ					127 396 832	29 837 296	12 842 380	15 968 179	16 804 944	18 021 670
06	AKUM	06370	TOTALI (Buxheti I Shtetit)					60 522 300	16 573 781	6 408 320	7 451 054	8 903 602	9 500 909
06	AKUM	06370	MINISTRIA E INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISE	vazhdim									
06	AKUM	06370	FURNIZIMI ME UJE DHE KANALIZIME	vazhdim									
06	AKUM	06370	REFORMA E UJIT	vazhdim	2022	vazhdim	Buxhet Shteti	1 844 746	-	80 000	512 816	547 814	479 086
06	AKUM	06370	REFORMA E UJIT (Pagesa e kapitalit per SKPUK)	vazhdim	2022	2023	Buxhet Shteti	91 800	-	76 500	15 300	-	-
06	AKUM	06370	REFORMA E UJIT (Ekspert per Transferimin e Aktivitetit sipas VKM)	vazhdim	2022	2023	Buxhet Shteti	70 000	-	50 000	20 000	-	-
06	AKUM	06370	Objektet ne vazhdim	vazhdim	2019	2023	Buxhet Shteti	50 271 330	16 573 781	6 201 820	5 982 959	6 657 495	6 785 953
06	AKUM	06370	Objekte e Reja	I Ri	2023	2025	Buxhet Shteti	8 244 424			919 979	1 698 293	2 235 870
06	AKUM	06370	Financimi i Huaj	vazhdim			Financim i Huaj	66 874 532	13 263 515	6 434 060	8 517 125	7 901 342	8 520 760
07	FSHZH	6 210	Objektet ne vazhdim dhe te reja	Vazhdim dhe te reja	2 023	2 025	Financim i Huaj dhe Buxhet Shteti	7 595 568	1 560 593	1 173 186	1 221 933	818 678	463 843
			TOTAL FINANCIM I BRENSHEM DHE FINANCIM I HUAJ - AKUM + FSHZH					134 992 400	31 397 889	14 015 566	17 190 112	17 623 622	18 485 513

3.1 Investimet përbërese të planeve strategjike për zbatimin e direktivave për ujin e pijshëm dhe ujërat e ndotura

Investimet përbërese të planit strategjik për zbatimin e direktivës për ujin e pijshëm

Kosto të investimeve kapitale – Zgjerimi i infrastrukturës (në EUR)

Shoqëri Rajonale (të reja)	Prodhimi I ujit)	Dizinfektimi/ Trajtimi I ujit	Linjat e dërgimit	Rrjeti shpërndares	Stacione pompimi	Rezervuare	Lidhje shërbimi	Total	Total 2025-2030	Total 2031-2040	Total 2041-2050
Berat	239,639	1,110,000	7,167,697	356,727	433,270	7,957,694	78,000	9,385,333	6,722,377	99,000	2,563,956
Diber	122,141	1,590,000	8,156,536	977,027	479,269	9,612,832	110,000	11,434,973	5,212,534	403,000	5,819,439
Durres	421,934	810,000	17,466,606	581,163	1,693,117	19,740,885	60,000	21,032,819	3,256,942	8,223,704	9,552,173
Elbasan	1,025,463	1,935,000	25,553,955	1,486,770	1,567,558	28,608,283	136,000	31,704,746	18,607,040	4	12,132,706
Fier	1,209,835	660,000	27,289,597	1,749,550	2,057,839	31,096,986	51,000	33,017,821	20,888,651	965,000	8,125,686
Gjirokaster	103,603	1,500,000	4,999,932	681,385	288,789	5,970,106	102,000	7,675,709	3,375,748	4,003,484	4,170,961
Korce	-	2,160,000	3,510,337	80,349	210,936	3,801,622	147,000	6,108,622	4,788,771	129,000	1,311,851
Kukes	-	1,020,000	2,165,425	77,574	125,204	2,368,203	71,000	3,459,203	1,332,829	8,000	1,593,374
Lezhe	355,060	750,000	10,360,371	510,204	693,737	11,564,312	55,000	12,724,372	9,558,757	533,000	2,930,785
Lushnje	811,814	540,000	13,624,181	823,918	953,076	15,401,176	41,000	16,793,990	13,292,508	234,830	3,368,481
Pogradec	-	675,000	62,075	-	3,860	65,935	47,000	787,935	783,985	133,000	2,950
Sarande	-	435,000	1,813,382	1,211	156,297	1,970,890	30,000	2,435,890	- 1,110,860	1,000	1,798,528
Shkoder	1,073,519	1,635,000	30,515,534	1,675,580	2,076,062	34,267,176	111,000	37,086,694	16,886,200	1,748,222	15,295,391
Tirane	1,018,501	1,230,000	60,406,526	1,839,744	7,204,311	69,450,582	92,000	71,791,083	- 28,715,817	2	50,305,901
Vlore	253,840	780,000	5,712,299	353,949	400,523	6,466,771	54,000	7,554,611	3,470,229	4,905,104	1,234,318
Total	6,635,348	16,830,000	218,804,454	11,195,150	18,343,849	248,343,452	1,185,000	272,993,801	78,349,895	74,437,405	120,206,501

Kosto të investimeve kapitale – Rehabilitimi i infrastrukturës (në EUR)

Shoqëri Rajonale (të reja)	Prodhimi I ujit	Dizinfektimi / Trajtimi I ujit	Linjat e dërgimit	Rrjeti shpërndares	Stacione pompimi	Rezervuare	Lidhje shërbimi	Total	Total 2025-2030	Total 2031-2040	Total 2041-2050
Berat	2,797,399	90,000	7,594,018	27,056,744	3,274,867	4,242,980	3,558,690	48,614,698	11,776,209	36,778,490	60,000
Diber	2,501,053	60,000	7,137,806	11,960,017	376,518	2,712,500	2,058,210	26,806,103	21,536,943	2,050,798	3,218,362
Durres	911,750	560,000	14,694,584	56,521,239	5,288,819	4,901,540	11,273,310	94,151,241	26,586,088	- 6,773,612	74,338,765
Elbasan	4,468,102	90,000	12,200,384	39,348,440	4,006,148	4,109,000	6,379,290	70,601,365	21,270,587	48,720,477	610,301
Fier	1,917,915	120,000	14,220,486	27,023,698	5,791,679	3,496,500	4,727,070	57,297,348	18,630,208	38,482,000	185,140
Gjirokaster	5,591,505	30,000	11,504,404	19,293,531	1,370,524	4,153,450	2,484,990	44,428,403	38,610,881	5,817,522	-
Korce	4,451,374	60,000	13,449,159	17,914,844	2,300,105	3,163,020	4,764,060	46,102,562	23,646,156	22,456,407	-
Kukes	2,585,380	60,000	6,132,641	23,332,673	1,591,415	1,084,440	1,063,890	35,850,439	17,065,502	5,363,903	13,421,033
Lezhe	2,111,160	60,000	5,036,850	27,141,723	853,440	3,102,400	2,521,620	40,827,193	18,123,638	21,676,620	1,026,935
Lushnje	1,034,795	30,000	3,050,677	18,898,774	2,126,907	1,340,500	2,644,740	29,126,394	22,367,313	6,546,107	212,974
Pogradec	905,355	30,000	677,856	7,031,816	553,063	1,193,500	1,583,820	11,975,409	4,681,647	7,293,763	-
Sarande	1,675,794	-	3,082,453	14,263,727	730,444	1,942,500	2,527,740	24,222,659	8,999,366	12,330,073	2,893,220
Shkoder	2,933,875	30,000	14,136,058	34,207,434	4,109,900	4,779,600	3,891,870	64,088,737	55,468,381	- 31,154,796	39,775,152
Tirane	1,439,451	90,000	8,753,540	112,044,842	6,138,912	13,819,400	25,106,940	167,393,085	38,755,533	113,132,743	15,504,810
Vlore	1,899,966	-	12,006,280	38,619,676	3,248,093	2,973,600	6,052,320	64,799,935	9,893,623	5,293,851	49,612,461
Total	37,224,875	1,310,000	133,677,197	474,659,178	41,760,833	57,014,930	80,638,560	826,285,573	337,412,075	288,014,345	200,859,153

Investimet përbërese të planit strategjik për zbatimin e direktivës për trajtimin e ujrave të ndotura urbane

Lloji I Investimit	Kosto Totale (milion Euro)	2025-2030 (milion Euro)	2031-2040 (milion Euro)	2041-2050 (milion Euro)
Grumbullim I ujrave të ndotura	1,196.91	219.04	549.89	427.99
Trajtimi I ujrave të ndotura	670.14	139.59	326.78	203.78
Paisje laboratorike	1.00	1.00	-	-
Totali Net Kosto e investimeve kapitale	1,868.06	359.62	876.67	631.77
Kosto inxhinierike dhe shtesa	467.01	89.91	219.17	157.94
Kosto totale e investimeve kapitale	2,335.07	449.53	1,095.83	789.71
Masa institucionale (Legala, Politikat etj)	19.5	8.8	10.7	0.0
Grand Totali (milion Euro)	2,354.57	458.33	1,106.53	789.71

Pjesa IV: Zbatimi, përgjegjësia e institucioneve, llogaridhënia, raportimi dhe monitorimi

4 Hyrje

Ky kapitull paraqet disa udhëzime për mënyrën se si do të zbatohet, monitorohet dhe përditësohet Strategjia aktuale gjatë zbatimit të saj. Është krijuar një sistem koherent monitorimi dhe vlerësimi në mënyrë që të sigurohet një arritje efikase dhe efektive e objektivave të strategjisë. Bashkërendimi i përgjithshëm i aktiviteteve në lidhje me strategjinë është përgjegjësi e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Çdo vit, MIE do të raportojë mbi përparimin në përmbushjen e objektivave, sa l përket aspektit cilësor dhe sasior të strategjise dhe planeve përkatëse, si dhe do të informojnë rregullisht Kryeministrin mbi zhvillimet në sektor.

Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektoril/ndërsektorial të integruar”, u miratua urdhri i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 217, datë 24.05.2019 “Për ngritjen e sekretariatit teknik, në kuadër të funksionimit të grupit tematik reforma e ujesjelles kanalizimeve”, ku Ministria e Infrastrukturës dhe Energjise luan rolin e sekretariatit teknik për grupin tematik “reforma në sektorin ujësjiellës kanalizime”.

Me urdherin e Ministri të Infrastrukturës dhe Energjisë nr.77, datë 20.04.2022 u ngrit Grupi Tematik për Reformën e Riorganizimit të Ujësjiellës Kanalizimeve sha, i cili luan edhe rolin e Komitetit Sektorial të Monitorimit të IPA-s për Reformën e Ujit, që drejtohet nga zëvendësministër i infrastrukturës dhe energjisë.

4.1 Planet e detajuara të zbatimit

Siç paraqitet Aneksin 1, çdo Objektiv Strategjik detajohet në Masat Prioritare dhe për cdo Masë Prioritare përcaktohen Planet e Veprimit. Institucionet përgjegjëse, duke përfshirë një Institucion Përgjegjës kryesor (lider), gjithashtu identifikohen dhe përcaktohen për të mbikqyrur zbatimin dhe monitorimin e Planeve e Veprimit për të arritur rezultatet e parashikuara (targetet) të vendosura për afate kohore të shkurtra, të mesme dhe të gjata.

Institucioni Përgjegjës kryesor do të hartojë një plan zbatimi të detajuar për secilën prej Masave Prioritare të përcaktuara, ku do të përshkruhet në mënyre të plotë si do të realizohet arritja e rezultateve të parashikuara. Këto plane të detajuara të zbatimit do të përfshijnë një qasje graduale në përputhje me rezultatet që parashikohet të arrihen për periudhat afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Këto plane duhet të përpunohen brenda tre muajve pas miratimit të këtij dokumenti dhe do të konsultohen në vijim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

4.2 Monitorimi dhe Raportimi i Strategjisë

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjëse për vlerësimin, monitorimin e progresit dhe zbatimin e kësaj Strategjie në bashkëpunim me institucionet e ndryshme përgjegjëse.

Monitorimi luan një rol kyç në vlerësimin dhe raportimin e progresit në zbatimin e një strategjie. Për më tepër, ai u ofron palëve të interesuara, në të gjitha nivelet, informacion kyç në lidhje me përparimin e zbatimit dhe sfidat e mundshme, duke bërë të mundur ndërmarrjen e veprime korigjuese sa herë që është e nevojshme. Procesi i monitorimit duhet të jetë i vazhdueshëm, i qëndrueshëm, i fokusuar dhe i disiplinuar.

Tabela 4-1, Proçesi i monitorimit

Karakteristikat e proçesit të monitorimit	Veprimet operacionale
I vazhdueshëm	Të kryhet mbi baza vjetore
I qëndrueshëm	Të përdoret e njëjta bazë dhe burim të dhënash në cdo kohë
I fokusuar	Të krahasohen arritjet me rezultatet e parashikuara
I disiplinuar	Të ndiqet një mekanizëm i veçantë monitorimi

- **Proçesi i vazhdueshëm**

Për të monitoruar zbatimin dhe progresin e Strategjisë Kombëtare, Institucioni Përgjegjës kryesor do të përgatitë një raportim vjetor që detajon arritjet në lidhje me Masat Prioritare të caktuara dhe Planet e Veprimit përkatëse.

- **Proçesi i qëndrueshëm**

Institucioni përgjegjës kryesor do të përdorë të njëjtën bazë dhe burim të dhënave për të monitoruar dhe raportuar përmirësimet dhe rezultatet e arritura në lidhje me masat prioritare të përcaktuara dhe planet e veprimit përkatëse. Në të vërtetë, vendosja e standardeve të qarta për raportimin e të dhënave është kritike për një monitorim efektiv.


- **Proçesi i fokusuar**

